



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 8 (827760)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 4 Mars 2022

Ministri Peleshi: Puna juaj në këtë sfidë të paqes, kontribut në lirinë e qytetarëve tanë, rajonit dhe botës

Një grup prej 30 efektivash Komando, nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë, i janë bashkuar misionit ndërkombëtar të NATO-s, të koduar "KFOR 1", në Pejë të Kosovës. Ceremonia e nisjes së kontingjentit në këtë mision u zhvillua në prani edhe të ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj dhe komandantëve të forcave. Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes e cilësoi këtë një

mision të një rëndësie të madhe për Kosovën, por edhe për rajonin e Ballkanit Perëndimor. "Pas tërheqjes dhe mbylljes së misionit në Afganistan, ne u angazhuam se do të vazhdojmë të rrisim pjesëmarrjen tonë në misione të NATO-s dhe ato ndërkombëtare në përgjithësi dhe ky është rasti. Ne po materializojmë shtimin e prezencës sonë në KFOR, për herë të parë çojmë në këtë mision, misionin "KFOR 1", një kontingjent special të djemve dhe vajzave më të mirë që ne

kemi në FA. Në këto ditë të sfiduara të paqes dhe sigurisë globale kjo e shton dyfish, e rrit vëmendjen, por edhe përgjegjshmërinë e secilit prej nesh e secilit prej jush për të shërbyer me profesionalizëm, me disiplinë ushtarake, me dinjitet në respektim të kodit të etikës dhe të vlerave të aleancës tonë", - u shpreh ministri. Duke folur për situatën e krijuar në Ukrainë dhe mesazhet e dhëna nga sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg...

» faqe 2



Situata në Ukrainë

Peleshi: Proceset tona integruese do të shpejtohen për të qenë një bllok demokratik kundër autokracive



» faqe 3

Gjeneralmajor Begaj: Ndhima e FARSH-së do të vijojë të intensifikohet në të gjitha fushat e bashkëpunimit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj priti në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Bashkim Jasharin, i cili po zhvillon një vizitë zyrtare në Tiranë. Gjatë takimit, u diskutuan çështje të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh me fokus të veçantë fushat e trajnimit, arsimimit dhe stërvitjes të personelit ushtarak midis dy vendeve. Në fjalën...



» Faqe 4

Efektivët e batalionit III të Këmbësorisë të Forcës Tokësore trajnohen në Gjermani

Kompania I e Batalionit III të Këmbësorisë të Forcës Tokësore (k1b3kFT), mori pjesë në stërvitjen "KFOR-30". Stërvitja në fjalë, u zhvillua në një nga qendrat më të mëdha stërvitore amerikane në Europë, "Joint Multinational Readiness Center" (JMRC) në Hohenfels, Gjermani. Gjatë periudhës stërvitore, efektivët e b3k morën njohuri dhe rritën aftësitë e tyre profesionale nëpërmjet temave të kontrollit dhe menaxhimit të turmave, reagimit ndaj...



» Faqe 6-7

Intervistë me kolonel (në pension) Jahaj dhe Berdaj "Historia nuk është analoge me përshkrimin e orës, por me mekanizmin që vë në lëvizje orën"

Faktet e reja rishikojnë të vjetrat. Dhe kështu qenka e thënë, që historia të shkruhet vazhdimisht. Të paktën në bibliotekën time kam disa "Histori Shqipërie", shkruar nga personalitete, por dhe një përmbledhje prej 4 vëllimesh, botuar pak vite më parë, dhe që mban vullën e Akademisë së Shkencave. Kur do të kemi një histori të saktë, të cilës nuk do t'i kthehemi më për ta përmbysur nga themelet? Në një intervistë për gazetën "Ushtria", dy ushtarakë...



» Faqe 6-7

TAKIMI

Zëvendësministria Bici pret komandantin e FSK-së, gjeneralletenant Bashkim Jasharin



Zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, priti në një takim komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Bashkim Jasharin.

Pasi e uroi për marrjen e detyrës së re, zonja Bici e përgëzoi gjeneral Jasharin për përparimet shumë pozitive që ka bërë FSK, kryesisht me ndihmën e aleatit të përbashkët strategjik, Shteteve të Bashkuara.

Zëvendësministria e njohu ushtarakun e lartë nga Kosova me vendimin e qeverisë

shqiptare për të shtuar trupat shqiptare në misionin e NATO-s në Kosovë, KFOR.

Dy bashkëbiseduesit folën edhe për planin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes, i cili përmban 50 aktivitete, kryesisht kurse, trajnime dhe stërvitje të përbashkëta. Ata gjithashtu vlerësuan faktin që kadetë nga Shqipëria studiojnë në Qendrën Stërvitore të FSK-së dhe kadetë nga Kosova ndjekin studimet në Akademinë e Forcave të Armatosura.



Niset kontingjenti i parë në misionin "KFOR 1" në Kosovë

Ministri Peleshi: Puna juaj në këtë sfidë të paqes, kontribut në lirinë e qytetarëve tanë, rajonit dhe botës

Një grup prej 30 efektivash Komando, nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë, i janë bashkuar misionit ndërkombëtar të NATO-s, të koduar "KFOR 1", në Pejë të Kosovës. Ceremonia e nisjes së kontingjentit në këtë mision u zhvillua në prani edhe të ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj dhe komandantëve të forcave.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes e cilësoi këtë mision të një rëndësie të madhe për Kosovën, por edhe për rajonin e Ballkanit Perëndimor. "Pas tërheqjes dhe mbylljes së misionit në Afganistan, ne u angazhuam se do të vazhdojmë të rrisim pjesëmarrjen tonë në misione të NATO-s dhe ato ndërkombëtare në përgjithësi dhe ky është rasti. Ne po materializojmë shtimin e prezencës sonë në KFOR, për herë të parë çojmë në këtë mision, misionin "KFOR 1", një kontingjent special të djemve dhe vajzave më të mirë që ne kemi në FA. Në këto ditë të sfiduara të paqes dhe sigurisë globale kjo e shton dyfish, e rrit vëmendjen, por edhe përgjegjshmërinë e secilit prej nesh e secilit prej jush për të shërbyer me profesionalizëm, me disiplinë ushtarake, me dinjitet në respektim të kodit të etikës dhe të vlerave të aleancës tonë", - u shpreh ministri.

Duke folur për situatën e krijuar në Ukrainë dhe mesazhet e dhëna nga sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg, ministri Peleshi u shpreh se: "Asnjë inç i kësaj Aleance nuk mund të preket, sepse NATO është



"Pas tërheqjes dhe mbylljes së misionit në Afganistan, ne u angazhuam se do të vazhdojmë të rrisim pjesëmarrjen tonë në misione të NATO-s dhe ato ndërkombëtare në përgjithësi dhe ky është rasti. Ne po materializojmë shtimin e prezencës sonë në KFOR, për herë të parë çojmë në këtë mision, misionin "KFOR 1", një kontingjent special të djemve dhe vajzave më të mirë që ne kemi në FA".

vëmendshëm, duhet të jemi vigjilentë, duhet të jemi me dinjitet përkrah aleatëve tanë dhe ta bëjmë flamurin tonë të valëvitet krenar krahas flamujve tjerë të Aleancës."

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj tha se: "Misione të tilla kanë përgjegjësi edhe për shkak të situatës pandemike, por aktualisht, e veçanta përcaktuese është situata shumë e turbullt e sigurisë që po zhvillohet dhe po precipiton në përshkallëzime të rrezikshme dhe tejet kërcënuese në Krahun Lindor të Aleancës. Siguria globale është më shumë se kurrë ndonjëherë e rrezikuar dhe e kërcënuar. Rajoni dhe vendi ynë nuk janë imunë ndaj këtyre veprimeve të Rusisë. Ndaj në këto situata të nxehta ju do të jeni atje për një kuptim të madh që bëhet edhe më kuptimplotë dhe domethënëse, për sigurinë, lirinë, paqen, për t'i shërbyer Aleancës dhe vendit tonë".

30 efektivët Komando do të shërbejnë në këtë mision krah aleatëve kroatë dhe italianë.

aleanca më e fuqishme ushtarake dhe politike në botë". Duke iu drejtuar efektivëve që u nisën me mision, ministri i Mbrojtjes theksoi: "Punën tuaj atje do doja ta shikonit çdo ditë si një kontribut për paqen edhe sigurinë globale, si një kontribut për lirinë e qytetarëve tanë, e qytetarëve të botës, e qytetarëve të rajonit, sepse në 48 orët e fundit normaliteti, siç e tha sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg, ka ndryshuar; jemi në një normalitet të ri. Pra, në një mënyrë të njëanshme, një fuqi si Rusia hoqi dorë nga parimet që mbanin si shtylla rendin botëror dhe riktheu historinë pas, në kohën e sferave të influencës edhe pushtimit të një shteti më të dobët nga një shtet më i fuqishëm. Ne duhet të jemi të

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi flet mbi situatën në Ukrainë dhe rajon

Peleshi: Proceset tona integruese do të shpejtohen për të qenë një bllok demokratik kundër autokracive

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi: “Situata në Ukrainë konsiderohet një agresion, luftë e vërtetë. Kjo luftë nuk do të jetë aq e shkurtër, siç është menduar në planet e Putinit. Ka një solidaritet, jo vetëm moral, por dhe ndihmash, kontribute, armatimesh dhe municionesh. S’ka vend për optimizëm në afat të shkurtër. Rajoni i Ballkanit është ndër rajonet më të rriskuara nga përhapja e valës së këtij agresioni. Serbia është me një axhendë fluide, e pavendosur drejt perëndimit. Artikulli 5 garanton integritetin e vendeve të NATO-s. Nuk flasim për skenar, për një konflikt në Ballkan. Vihet re një lloj destabiliteti politik. Proceset që para agresionit rus kishin filluar të merrnin jetë, siç është Ballkani i Hapur apo dhe dialogu Serbi-Kosovë. Ky lloj destabiliteti politik në vendet që përmenda, si në Bosnjë, ka influenca ruse, apo të vendeve të tjera si Kina, e bëjnë rajonin tonë, një rajon që mund të ndjejë valën e destabilitetit. Është luftë që ka thyer shumë rregulla, parime. Nuk jemi në një situatë për të fjetur gjumë, por meriton të rritet vigjilenca. Këtë kemi bërë kohët e fundit. Jemi të avantazhuar. Kjo situatë na gjeti në një kohë kur Shqipëria është anëtare jo e përfunduar e Kombeve të Bashkuara. Nuk është rastësore që buxheti i mbrojtjes u rrit. NATO po shton prezencën e vet me trupa në kufijtë lindor të NATO-s. Edhe në rajonin tonë, misioni i KFOR-it është përforcuar duke rritur gatishmërinë. Ne jemi pjesë e tyre, me një kompani dhe një togë në Kosovë. Jemi angazhuar dhe me kontribute shtesë dhe presim se kur do të caktohem në kufijtë lindor të Ukrainës.”

Më tej ministri Peleshi do sillte në vëmendje situatën ekonomike që krijohet me prishjen e marrëdhënieve në rast lufte: “E keqja nuk vjen për mirë. Kjo do ndihet në të gjithë botën. Po vijmë nga një situatë që pas vitit ‘90 zhvillimet dhe marrëdhëniet mes shteteve

bazoheshin te tregtia e lirë. Nuk mendohej se kaq shpejt do të prishej ky rend. Në vitin ‘90 një filozof i kohës shkroi një ese të famshme të titulluar: “Fundi i Historisë”. Rusia është një prodhues dhe furnizues i burimeve energjetike në Europë, por dhe në furnizimin me drithëra. Duke qenë se këto dy vende

janë në luftë, kjo do të ketë impakt te ne. Duhet treguar kujdes i shtuar nga reagimi i tregjeve. Kemi marrë informacione nga Ministria e Bujqësisë, e cila ka bërë dhe pasqyrën e tregut. Pothuajse të gjitha drithërat që vijnë nga Ukraina dhe Rusia, mund të zëvendësohen nga vende të tjera. S’bëhet fjalë për

mungesa në treg, por zëvendësim me produkte të tjera. Duhet të përgatitemi për më të keqen që të shpresojmë më të mirën. Kemi rritur vigjilencën dhe vëzhgimin e vazhdueshëm të të gjitha sinjaleve. Kjo sa i përket çmimeve dhe stokut. Një destabilitet kaq i madh në dy tregjet e rëndësishme për furnizimin e

Europës dhe Shqipërisë, mund të sjellë vonesa por dhe bllokime. S’ka sinjale për mungesa në treg.”

“Unë nuk mund të flas teknikisht se nuk është sektori për të cilin punoj. Jam i bindur se ministritë përgjegjëse do marrim masa. Spekulantët në treg përfitojnë, por do ishte e paligjshme që të spekulohet me këtë situatë. S’kam në tavolinë ndonjë raport që të më thotë se kjo gjë po ndodh. Ky agresion ka provokuar një rritje të solidariteti, uniteti dhe kohezionit brenda Europës. Unë shpresoj se kjo do të reflektojë në rritje të shpejtësisë të proceseve integruese të vendeve tona në Europë. Besoj që edhe Ballkani Perëndimor do të duhet të merrte shpejtësi më të madhe në tejkalimin e disa mosmarrëveshjeve tona, ndërkohë që një pjesë e botës ka hyrë në luftë. Ne pengohemi nga disa shtete që janë peng i historisë tonë ballkanike. Në konferencën e Sigurisë në Mynih, e ngrita këtë çështje ku nga i gjithë paneli u gjet mbështetja pozitive.

Proceset tona integruese do të shpejtohen për të qenë një bllok demokratik kundër autokracive. Kryeministri Rama, në samitin e liderëve të NATO-s, ka qenë nga të parët liderë që ka vetë-ofruar vendin tonë për të pritur refugjatët ashtu siç ka bërë me afganët. Ka qenë i vetmi që ka paralajmëruar se nëse do të ketë valë refugjatësh afganë vendi ynë hap derë dhe ne kështu bëjmë. Por edhe në këtë rast është konfirmuar zyrtarisht dhe përpara NATO-s, ne jemi të gatshëm të mirëpresim sa të jetë e nevojshme”.



Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s, të akredituar në vendin tonë, vizitë në Bazën Ajrore Farkë

Atashetë ushtarakë të huaj të vendeve të NATO-s zhvilluan një vizitë në Bazën Ajrore Farkë, ku u pritën nga shefi i degës operationale në komandën e Forcës Ajrore, kolonel Genci Petanaj dhe komandanti i Bazës Ajrore Farkë, nënkolonel Julian Dulemata.

Qëllimi i kësaj vizite ishte, njohja me kapacitetet, modernizimin dhe rëndësinë që ka Baza Ajrore Farkë për përmbushjen e misionit dhe realizimin e detyrave.

Mbas fjalës së mirëseardhjes për atashetë ushtarakë, u mbajt prezantimi njohës për Bazën Ajrore Farkë, me historikun, misionin, strukturën, infrastrukturën, kapacitetet, arsimimin, trajnimin, operationet aktuale dhe objektivat e së ardhmes.



Më tej, pati një sesion pyetjesh, diskutimesh dhe përgjigjesh, të fokusuara në zhvillimet e kapaciteteve të mjeteve fluturuese duke u pasuar me një tur dhe

vizitë në Bazën Ajrore Farkë.

Atashetë Ushtarakë u takuan me komandantin e Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, i cili pasi falën-



deroi për vizitën dhe bashkëpunimin e mirë e të vazhdueshëm me ushtritë e vendeve anëtare të NATO-s, theksoi dhe informoi se, Forca Ajrore është në proces modernizimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm të infrastrukturës, kapaciteteve të mjeteve fluturuese por edhe të burimeve njerëzore.

Në fund të takimit u shkëmbyen dhurata, duke shprehur në të njëjtën kohë edhe përshtypjet pozitive të ndërsjella, të vijimit të bashkëpunimit për të ardhmen sipas prioritetëve të Forcës Ajrore dhe fushave të bashkëpunimit ushtarak me interes të përbashkët.

SHSHP të FA gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj pret komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jasharin

Gjeneralmajor Begaj: Ndihma e FARSH-së do të vijojë të intensifikohet në të gjitha fushat e bashkëpunimit, në siguri dhe mbrojtje


Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj priti në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jasharin, i cili po zhvillon një vizitë zyrtare në Tiranë.

Gjatë takimit, u diskutuan çështje të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh me fokus të veçantë fushat e trajnimit, arsimimit dhe stërvitjes të personelit ushtarak midis dy vendeve.

Në fjalën e tij në takim, gjeneralmajor Begaj vlerësoi progresin e bërë nga FSK për transformimin e saj sipas standardeve perëndimore dhe e cilësoi misionin e KFOR-it në Kosovë si një sukses për paqen dhe sigurinë rajonale.

Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj gjatë takimit e garantoj komandantin e FSK-së se asistencën e FARSH-së do të vijojë të intensifikohet në të gjitha fushat që përmban marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, e nënshkruar nga ministrat e Mbrojtjes të vendeve respektivë, gjatë vitit 2021.

Nga ana e tij, gjenerallejtënant Bashkim Jashari falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për kontributin dhe rolin e tij në mbështetje të aderimit të FSK në nismat dhe organizmat ushtarake rajonale të Ballkanit Perëndimor, si dhe angazhimin e FARSH për



sigurinë e Republikës së Kosovës në kuadër të misionit të KFOR-it.

Të dy ushtarakët e lartë ndanë të njëjta qëndrime lidhur me ndryshimet e fundit të situatës së sigurisë, duke theksuar nevojën e rritjes së bashkëpunimit me qëllim adresimin e koordinuar të sfidave në rajon dhe më gjerë.

Kjo është vizita e parë zyrtare e gjenerallejtënant Bashkim Jasharit në Tiranë pas marrjes së detyrës së komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në dhjetor 2021.



Gjenerallejtënant Bashkim Jashari falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për kontributin dhe rolin e tij në mbështetje të aderimit të FSK në nismat dhe organizmat ushtarake rajonale të Ballkanit Perëndimor, si dhe angazhimin e FARSH për sigurinë e Republikës së Kosovës në kuadër të misionit të KFOR-it.

BASHKËPUNIMI

Forca Tokësore vizitohet nga komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës

Komandanti i Forcës Tokësore (FT), gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari.

Pasi i uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Tokësore (KFT) ushtarakut madhor të Republikës së Kosovës, në bisedën e zhvilluar më tej me të, gjeneral Kingji nënvizoi progresin transformues që ka pësuar FSK, duke u bërë çdo ditë e më tepër një ushtri profesioniste, e aftë për të marrë përsipër çdo lloj misioni dhe detyrë të ngarkuar.

Gjithashtu, ai e garantoj gjenerallejtënant Jasharin, se tek FT, do të gjejë gjithmonë mbështetje dhe bashkëpunim të pakufishëm në fushën e mbrojtjes, kjo në interes të rritjes së paqes dhe sigurisë në rajon, aspirata këto që ndajnë të dyja ushtritë tona.

Nga ana e tij gjeneral Jashari, pasi shprehu mirënjohjen për pritjen e rezervuar në KFT, falënderoi gjeneral Kingjin për marrëdhënien e shkëlqyer



dhe vëllazërore që ekziston ndërmjet dy Forcave të Armatosura. Ai shprehu besimin, se bashkëpunimi dypalësh, do të vazhdojë të rritet dhe të thellohet edhe më tepër në të ardhmen.

Takimi, u zhvillua nën një atmosferë të ngrohtë dhe vëllazërore.



Efektivët e batalionit III të Këmbësorisë të Forcës Tokësore trajnohen në Gjermani

Kompania I e Batalionit III të Këmbësorisë të Forcës Tokësore (k1b3kFT), mori pjesë në stërvitjen “KFOR-30”. Stërvitja në fjalë, u zhvillua në një nga qendrat më të mëdha stërvitore amerikane në Europë, “Joint Multinational Readiness Center” (JMRC) në Hohenfels, Gjermani.

Gjatë periudhës stërvitore, efektivët e b3k morën njohuri dhe rritën aftësitë e tyre profesionale nëpërmjet temave të kontrollit dhe menaxhimit të turmave, reagimit ndaj minave surprizë, drejtimit të mjeteve të blinduara etj. Stërvitja “KFOR-30” kishte si synim aftësimin e trupave për sigurimin e paqes dhe stabilitetit, në rajonin e Kosovës. Trajnimi, u zhvillua nga instruktorët amerikanë dhe nga ata të policisë ushtarake gjermane.

Në ushtrimin stërvitor të koduar “Bronze Shield”, efektivët e k1b3kFT realizuan me sukses këto detyra kryesore: patrullim përgjatë vijës kufitare me qëllim identifikimin dhe ndalimin e kontrabandës, forcë e reagimit të shpejtë për lirimin e rrugëve në raste protestash, etj.

Forca Tokësore është pjesëmarrëse me trupat e saj në stërvitjet KFOR të zhvilluara në Gjermani, për të disatin vit radhazi.



Në zbatim të plan-kalendarit të stërvitjeve për vitin 2022, Forca Tokësore (FT) zhvilloi stërvitjet dimërore 72-orëshe.

Këto stërvitje, gjetën të angazhuar pothuajse të gjithë repartet e vartësisë së kësaj Force. Konkretisht, batalioni I i Këmbësorisë (b1k), u angazhua në stërvitjen e koduar “Furtuna-22”, në rajonin Bicaj Pukë; batalioni i Dytë i Këmbësorisë (b2k), zhvilloi stërvitjen e koduar “Mbijetimi-22” në rajonin e Vithkuqit, Korçë; batalioni “Komando” zhvilloi stërvitjen “Selita 01”, Bicaj Pukë dhe batalioni i Forcave Speciale zhvilloi stërvitjen “Selita 02” në Voskopojë.

Qëllimi i këtyre stërvitjeve, ishte testimi i kapaciteteve operacionale, për të vepruar në kushte të vështira të motit dhe terrenit, sipas skenarëve dhe ideve taktike, të përcaktuara në programet vjetore stërvitore. Njëkohësisht, u testuan me sukses edhe aftësitë dislokuese të forcave dhe mjeteve të reparteve të përfshirë në trajnim.

Nga të gjithë efektivët pjesëmarrës në këto lloj trajnimesh, u demonstroi përgatitje e lartë fizike, duke sfiduar temperaturat e ulëta dhe terrenet

Forca Tokësore përmbyll me sukses stërvitjet dimërore



malore më dëborë, karakteristike për rajonet ku u zhvilluan stërvitjet.

Stërvitjet dimërore, janë pjesë e programit të trajnimit të trupave tokësore, me qëllim rritjen e



aftësive të tyre profesionale, për të qenë të gatshëm për të vepruar në çdo kohë dhe situatë, në përgjigje të sfidave dhe kërcënimeve që rrezikojnë paqen dhe stabilitetin.

INTERVISTA

Intervistë me kolonel
(në pension) Zeno Jahaj
dhe Agron Berdaj

“Historia nuk është analoge me pëershkrimin e orës, por me mekanizmin që vë në lëvizje orën”

Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Faktet e reja rishikojnë të vjetrat. Dhe kështu qenka e thënë, që historia të shkruhet vazhdimisht. Të paktën në bibliotekën time kam disa “Histori Shqipërie”, shkruar nga personalitete, por dhe një përmbledhje prej 4 vëllimesh, botuar pak vite më parë, dhe që mban vulën e Akademisë së Shkencave.

Kur do të kemi një histori të saktë, të cilës nuk do t’i kthehemi më për ta përmbysur nga themelet?

Në një intervistë për gazetën “Ushtria”, dy ushtarakë, kolonel (në pension) Zeno Jahaj dhe Agron Berdaj, na e sjellin në një dimension tjetër historinë e Luftës së Dytë Botërore, pa ndikime politike, duke iu referuar dokumenteve origjinale të kohës, të cilët i sjellin për lexuesin ushtarak, por jo vetëm, si një panoramë të gjallë të asaj periudhe nëpërmjet librit të tyre “Përtej Shtrembërimeve”.

Cilat janë arkivat më të besueshme nga të cilat historia e Shqipërisë i afrohet më shumë realitetit?

Sigurisht që janë historianët ata që e shkruajnë e historinë. Por arkivat janë buka, ushqimi i çdo historishkrimi, i çdo historiani. Shqipëria ka arkivat e saj kombëtare, në kuptimin e arkivave qendrore shtetërore. Por, ajo ka edhe arkivat e institucioneve, të cilat, për vetë natyrën e tyre, kanë qenë përfaqësuese në marrëdhëniet e Shqipërisë me shtete të tjerë (Ministritë së Punëve të Jashtme, Ministritë së Mbrojtjes, etj.). Ndërkohë, shteti shqiptar, për më tepër një vend relativisht i vogël, ka qenë i lidhur dhe i kushtëzuar nga marrëdhëniet me shtete apo aktorë të tjerë, të cilët, në kohë të caktuara historike, kanë influencuar zhvillimet në Shqipëri. Prandaj arkivat osmane, italiane, gjermane, ato të Vatikanit, e të tjera, janë të domosdoshme për t’iu adresuar nëse dëshiron ta pasqy-



rosh sa më objektivisht historinë.

Sa mendoni se është ndikimi politik në shkrimin e historisë?

Historishkrimi përjetoi subjektivizëm e njëanshmëri në vitet e shtetit komunist. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, pluralizmi politik solli edhe pluralizmin e shkrimit të historisë, domethënë shumëllojshmëri faktesh e interpretimesh. Nga kjo pikëpamje, pluralizmi i historishkrimit është afërmim drejt së vërtetës, sepse plotëson faktet që ishin mohuar apo këndvështrimet e ndryshme analitike.

Por, kjo pasuri faktesh dhe fuqi

interpretative solli edhe një fenomen të ri dhe të vjetër njëkohësisht: historishkrimin për qëllime politike të ditës, i cili e shtrembëron të vërtetën dhe historinë.

Por historia është shkencë, jo politikë.

E vërteta është se ne, në këto tre dekada të pluralizmit politik, nuk kemi një histori, por dy histori, të cilat shkojnë deri te diskutime të rëndomta emrash, datash e deri orësh, sikur historia të ishte një garë maratone. Por nëse historia dhe shkenca na kanë mësuar ndonjë gjë, mësimi kryesor që na kanë mësuar është se pasioni dhe dëshira nuk janë e njëjta e vërtetë.

Por dyzimi i historisë sonë, për shkak pikërisht të dëshirës dhe pasionit, ka prekur deri edhe tekstet shkollore, duke krijuar kështu një boshllëk në arsimimin dhe kulturën kombëtare. Për të mos thënë që na qeshin edhe bota kur dy historianë, dy politikanë apo dy ushtarakë paraqesin versione personale të historisë kombëtare.

Cilat mendoni se janë kriteret për shkrimin e historisë?

Historishkrimi duhet të jetë objektiv. Historia nuk mund të ndahet nga shkrimi i saj, sepse në të kundërt shkrimi quhet fantazi dhe fantazia

nuk është histori. Historia nuk bëhet me thashetheme, por me dokumente. Ai që shkruan duhet të çojë veten te koha për të cilën shkruan, jo të sjellë te vetja kohën për të cilën shkruan. Historia shkruhet me prova. Por jo prova të njëanshme.

Në çdo histori marrin pjesë dhe ndërmjetësojnë shumë aktorë dhe faktorë. Të gjithë do të duhen analizuar, jo vetëm aktori apo faktori që ju plotëson synimin.

Ju nuk mund të nxirrni përfundime historike kur shkëputeni nga rendi i gjërave. Një ngjarje ka rezultuar për shkak se është pararendur nga ngjarje të tjera. Historia, prandaj nuk mund të dalë jashtë parimit të konsistencës, të vijimësisë, së lidhjes organike të fakteve në rendin e tyre kohor, jo në gjendjen e tyre të një çasti të vetëm.

Dhe themeloria: kur shkruani historinë, zbuloni pse-të e ngjarjeve, jo përshkrime bëmash të rëndomta. Siç thotë një historian i madh: “Historia nuk është analoge me pëershkrimin e orës, por me mekanizmin që ve në lëvizje orën”.

Çfarë ishte në të vërtetë Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar? Luftë çlirimtare apo luftë civile?

Kemi parë se autorë librash e shkrimesh, si dhe politikanë e pasues të tyre, të prirur nga interesa politike, më shumë se sa nga faktet historike, pa instrumentet që nevojiten për interpretimin e tyre, e trajtojnë luftën antifashiste e antinaziste të zhvilluar në Shqipëri sikur të ishte “luftë civile”.

Ne studiuam rreth 213 luftëra civile që janë zhvilluar në botë në periudhën kohore 1816-1997, dhe veçanërisht ato që janë kryer në vende të afërta gjeografikisht me Shqipërinë, dhe të të njëjtës kohë me Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare të Popullit Shqiptar, domethënë të kohës së Luftës së Dytë Botërore. Ka dallime thelbësore një luftë e zakonshme nga lufta civile. Nuk është çështje etiketimesh, të cilat mund të vihen e të hiqen sipas orekseve apo syzeve. Lufta civile është një kategori lufte, e cila duhet të përmbushë një kuadër



kriteresh të pranuar nga shkencat historike e ushtarake, për t'u quajtur si e tillë.

Partitë/organizatat politike shqiptare të asaj kohe, pavarësisht ashpërsimit të skajshëm të gjuhës politike, praktikisht iu ruajtën përplasjes që do mund të shkonte deri në luftë civile.

Nga ana tjetër, edhe aktorët aleatë të cilët mbanin në vëmendje e në mbështetje Shqipërinë, në shumë deklarata të tyre të lëshuara gjatë gjithë luftës e deri në fund të saj, janë shprehur se nuk do të mbështesnin asnjë forcë politike që do mund ta çonte vendin në luftë civile, çka do të thotë se vendi nuk e përjetoi një luftë të tillë.

Rastet kur formacione të ndonjë partie/organizate politike shqiptare, bashkëpunuan e bashkërenduan në krah dhe në mbështetje të forcave gjermane, për të luftuar kundër formacioneve të partisë/organizatës tjetër politike shqiptare, nuk mund të quhen “luftë civile”. Rreshtimi i një individi apo force ushtarake në mbështetje të pushtuesit, cilat do të jenë motivet, e bën atë individ apo atë forcë, palë me pushtuesin, domethënë njësh me uniformën ushtarake të pushtuesit.

Ndërkohë, ndonjë akt masakrimi, i ideuar dhe i kryer në mënyrë individuale, domethënë jo për arsye përfaqësimi të njëres apo të tjetres palë politike kundër palës tjetër politike, nuk mund të njësohet e cilësohet si “luftë civile”, por thjesht, ashtu siç kanë qenë në fakt, akte masakrimi. Fakti që këto akte janë dënuar nga të gjitha forcat e interesuara politike, në atë kohë e më vonë, publikisht e jo publikisht, e përjashton që këto akte të cilësohen “luftë civile”.

Termet “nacional” dhe “kombëtar” duket se i ndanë qasjet e forcave politike në dy kampe. Çfarë roli luajtën këto terma në këtë luftë dhe pse u abuzua me to?

cat politike shqiptare të asaj kohe, i përvetësuan termat “nacional” apo “kombëtar”, si pjesë të “logos” së tyre, për të fituar sa më shumë mbështetje popullore. Por, në radhë të parë, terma të tilla, ato i përfshinë si pjesë të programit të tyre politik dhe me qëllime të justifikuar kombëtare.

Ajo luftë ishte e adresuar dhe u krye për çlirimin nga nazifashizmi, si të shteteve-kombe, edhe të kombeve në përgjithësi. Në këtë kuadër, forcat politike shqiptare ishin në të drejtën dhe detyrimin e tyre të krijonin prani e lidhje simetrike gjithëkombëtare, domethënë të zhvillonin aktivitet luftarak edhe në hapësirat e tjera shqiptare jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë.

Të gjitha këto, e justifikojnë



komunist ishte ai që gjeti terrenin të përqafohej shpejt nga masat. Kush ishte faktori që e favorizoi për t'u zhvilluar së tepërmi në Shqipëri dhe boshtin e lindjes?

Parashtruesit e tezës së të ashtuquajturës “luftë civile”, e kanë justifikuar hapur këtë, edhe me domosdoshmërinë e luftës kundër komunizmit dhe komunistëve në Shqipëri dhe, me këtë motiv, disi mbyturazi, kanë lënë të kuptohet, dhe lënë edhe sot të kuptohet, sikur bashkëpunimi me forcat pushtuese, veçanërisht ato gjermane, ishte i justifikuar.

Por, nëse komunizmit si ideologji totalitare nuk duhej t'i lëshohej terren që në fillimet e tij, këtë mision nuk mund ta merrte përsipër e as mund

të tyre.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik nuk mbeti thjesht një nga shumë fuqitë e mëdha europiane, sikurse kishte qenë tradicionalisht, por njëra nga dy superfuqitë e botës. Kjo shpërndarje e re e fuqisë, solli edhe një shpërndarje të re të ideologjisë. Ideologjia që përfaqësonte Bashkimin Sovjetik, aspironte jo thjesht gjysmën e botës, por u fut në garë për të pushtuar botën. Ekonomia e planifikuar komuniste, dukej se premtonte zhvillim të shpejtë, modernizim dhe fuqi ushtarake. Numri relativisht i madh i shteteve që u orientuan për nga komunizmi si ideologji politike, ishte një eksperiment i ri, i papraktikuar më përpara.

Komunizmi po shfaqej si ide-

të tjerë, të cilët do të ishin ndër të parët që do të josheshin nga premtimet e komunizmit. Në fillimet e tij si sistem politik, domethënë në brezin e parë, që fillon në vitin 1917 dhe përfundon me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, komunizmi përbënte shpresë. Madje, ai mbeti shpresë edhe për një a dy dhjetëvjeçarë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Për më tej, komunizmi, për shkak të deficiteve të tij, ra si regjim politik. Atë, e mundi regjimi demokratik, përmes garës paqësore ekonomike. Por komunizmin nuk mund ta mposhtnin as nazizmi, as fashizmi me instrumentet e tyre gjakatare, vrasjet dhe shfarosjet në masë.

Çfarë ka mbetur ende për t'u thënë nga këto materiale që po hulumtoni?

Është e pajustificuar të mos kemi historishkrime serioze, të paktën për etapat vendimtare që ka kaluar Shqipëria dhe kombi shqiptar. Është e pajustificuar që për historishkrimin, sidomos për luftërat e ushtritë, të mos bëhen pjesë ushtarakët, të cilët arsimohen profesionalisht për çështje të ushtrisë e të luftës. Sigurisht që universiteti i ka pajisur historianët me instrumente histori-kërkimi edhe për çështje të luftës. Por luftërat, operacionet, betejat, luftimet, tërheqjet e të tjera kategori të luftës, janë edhe çështje profesionale ushtarake, madje kryesisht çështje profesionale ushtarake. Për histori-kërkimin e këtyre çështjeve, ushtarakët janë pajisur posaçërisht me instrumente nga shkollat dhe akademitë e luftës, të mbrojtjes dhe ato ushtarake. Shqipëria nuk e ka, dhe duhet ta ketë një histori të plotë ushtarake të ushtrisë shqiptare të kohës së themelimit të shtetit shqiptar. Ajo histori nuk është çështje emrash apo biografish të ministrave apo të shefave të shtatmadhorisë. Ministrat dhe gjeneralët sigurisht që janë pjesë e historisë ushtarake, por jo historia ushtarake.

Shqipëria nuk e ka, dhe duhet ta ketë një histori të plotë ushtarake të ushtrisë shqiptare të kohës së Mbretërisë Shqiptare. Ajo ushtri, si çdo ushtri, mund të ketë pasur problemet e saj në organizim, në armatim, në arsimim, në marrëdhënie me ushtri të tjera, apo e çorientuar në çaste dhe për veprime vendimtare, por ishte ushtria e shtetit shqiptar, pjesë e historisë ushtarake të Shqipërisë.

Ashtu sikundër për ushtrinë shqiptare të pas vitit 1990 nuk kemi një histori se si u zhvillua, si dhe pse duhej kurrur, si u arsimua e trajnuar, si shërbeu brenda e jashtë vendit, ç' kapacitete ka krijuar, ç' peshë ka pasur në integrimin e vendit në NATO, etj.

Ne jemi ushtarakë, por në radhë të parë jemi qytetarë. Jo thjeshtë taksapagues, por partnerë për të ardhmen e sigurisë dhe mbrojtjes tonë kombëtare. Prandaj kemi të drejtë të dimë çfarë force të armatosur mbajmë e mbështesim dhe çfarë është ajo në gjendje të bëjë.

Dikush e ka detyrim që ta respektojë këtë të drejtë.

● Janë historianët ata që e shkruajnë e historinë. Por arkivat janë buka, ushqimi i çdo historishkrimi, i çdo historiani. Shqipëria ka arkivat e saj kombëtare, në kuptimin e arkivave qendrore shtetërore. Por, ajo ka edhe arkivat e institucioneve, të cilat, për vetë natyrën e tyre, kanë qenë përfaqësuese në marrëdhëniet e Shqipërisë me shtete të tjerë (Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Mbrojtjes, etj.).

plotësisht vlerën dhe potencialin nacional-çlirimtar të asaj lufte. Kështu që termi “nacionalist” nuk mund të monopolizohet, dhe as ka vend të monopolizohet, nga vetëm ndonjë individ, organizatë apo parti politike e asaj kohe. Adresimi i termit “nacionalist” tek bejlerë, çifligarë, bajraktarë, etj., sikur vetëm këta kërkonin bashkim kombëtar është privatizim abuziv. Çështjet e bashkimit kombëtar as kanë qenë, as janë dhe as do të jenë ndonjëherë atribut të statusit të pasurisë materiale, por të shpirtit të popullit shqiptar, pa dallim statusi.

Me mbarimin e luftës, sistemi

ta kryente një ideologji ngjashëm totalitare si nazizmi e fashizmi, dhe as bashkëpunimi me regjime pushtuese, koloniale, raciste e gjenocidiale, si ai i Hitlerit dhe Musolinit. Për më tepër, komunistët, jo vetëm në Shqipëri, u radhitën në krye të luftës pikërisht kundër ideologjive e regjimeve totalitare naziste e fashiste. Kësisoj, ata u bënë dhe u pranuan, madje edhe ndërkombëtarisht, si kundërpesha kryesore ndaj nazizmit e fashizmit. Mbështetja te Gjermania Naziste apo te Italia Fashiste, rezultoi orientim i gabuar, si për Shqipërinë e kombin shqiptar, ashtu edhe për vetë organizatat apo individët mbështetës

alizëm, besim e shpresë që zhduk pabarazinë nga e cila kishin vuajtur në kapitalizëm. Dimensioni komunist kishte zënë vend edhe në Perëndim, madje pikërisht atje ishte ngjizur. Për më tepër, në Francë dhe në Itali, partitë komuniste, në zgjedhjet pas Luftës së Dytë Botërore, fituan përkatësisht 20 dhe 40 për qind të votave popullore. Kësaj prirjeje nuk do t'i shpëtonte as Shqipëria. Në kushtet e varfërisë së shoqërisë shqiptare, oferta komuniste bëhej akoma më tërheqëse. Populli shqiptar, për nga statusi ekonomik renditej ndër popujt e varfër, sikurse ishin ata rusë, kinezë, ballkanikë, e

E vërteta është, se të gjitha for-

Aleatët e NATO-s do të qëndrojnë së bashku për të mbrojtur njëri-tjetrin

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg zhvilloi një vizitë në Poloni, më 1 mars 2022, ku së pari vizitoi bazën ajrore në Lask. Ai së bashku me presidentin polak Andrzej Duda takoi trupa nga Polonia dhe Shtetet e Bashkuara, dhe përgëzoi shërbimin dhe sakrificën e tyre.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO po forcon praninë e saj mbrojtëse në të gjithë pjesën lindore të Aleancës në përgjigje të pushtimit brutal të Ukrainës nga Rusia. “Në këtë bazë ajrore, ne shohim solidaritetin e aleatëve në veprim: avionë luftarakë nga Shtetet e Bashkuara po fluturojnë së bashku me Forcat Ajrore Polake, duke mbajtur qiellin e NATO-s të sigurt 24/7”, -tha ai.

Sekretari i Përgjithshëm zhvilloi gjithashtu bisedime me Presidentin Duda për të diskutuar pushtimin e Rusisë, si dhe mbështetjen e NATO-s për Ukrainën dhe parandalimin dhe qëndrimin e mbrojtjes. “Falënderoj Poloninë për mbështetjen dhe forcën e saj në këtë moment të rrezikshëm për sigurinë europiane”, -tha zoti Stoltenberg. Ai përshëndeti faktin që Polonia ka hapur kufijtë e saj për qindra mijëra refugjatë që ikin nga konflikti.

“Lufta e Putinit na prek të gjithëve dhe aleatët e NATO-s do të qëndrojnë gjithmonë së bashku për të siguruar dhe mbrojtur njëri-tjetrin”, -tha ai. Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje gjithashtu se NATO po vendos elementë të Forcës së Reagimit të NATO-s për herë të parë në historinë e saj. “Sot, trupat franceze po mbërrijnë në Rumani si elementi kryesor i kësaj force. Angazhimi ynë ndaj nenit 5, klauzola jonë e mbrojtjes kolektive, është e veshur me hekur”, -tha ai. Në të njëjtën kohë, Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO është një Aleancë mbrojtëse që nuk kërkon konflikt me Rusinë. Ai i bëri thirrje Rusisë që të ndalojë menjëherë luftën, të tërheqë forcat e saj nga Ukraina dhe të angazhohet me mirëbesim në përpjekjet diplomatike.

“Polonia, rol udhëheqës në këtë kohë të rrezikshme për Europën”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg dhe Presidenti i Polonisë, Andrzej Duda, mbajtën një konferencë të përbashkët për shtyp në



bazën ajrore ushtarake Lask në Poloni.

“Është mirë të kthehesh në bazën ajrore Lask. Unë kam qenë këtu për herë të parë në 2014 dhe sot, unë shoh se si kjo bazë ajrore vërtet demonstroi NATO-n, unitetin dhe praninë e NATO-s.” Stoltenberg falënderoi presidentin Duda: “...për angazhimin tuaj të fortë personal ndaj NATO-s, për Aleancën tonë transatlantike dhe rëndësinë e të qëndruarit së bashku”, -tha ai.

“Presidenti Putin ka shkatërruar paqen në Europë. Aleatët dënojnë pushtimin e pajustificuar dhe brutal të Ukrainës. Sulmi rus është krejtësisht i papranueshëm dhe kjo është mundësuar nga Bjellorusia.

Aleatët e NATO-s i ofrojnë mbështetje Ukrainës. Ne e mirëpresim rolin udhëheqës të Polonisë.

Ju po hapni kufijtë tuaj për qindra mijëra refugjatë që ikin nga konflikti dhe falënderoj Poloninë për mbështetjen dhe forcën e saj në këtë kohë të rrezikshme për Europën. Lufta e Putinit na prek të gjithëve

dhe aleatët e NATO-s do të qëndrojnë gjithmonë së bashku, për të siguruar dhe mbrojtur njëri-tjetrin. Në këtë bazë ajrore ne shohim solidaritetin aleat në veprim. Avionë luftarakë nga Shtetet e Bashkuara po fluturojnë së bashku me Forcat Ajrore Polake, për të mbajtur qiellin e NATO-s të sigurt, 24/7. Gjatë javëve të fundit kemi shtuar praninë tonë në pjesën lindore të Aleancës dhe sot, ne po vendosim për herë të parë në historinë tonë Forcën e Reagimit të NATO-s.

Sot, trupat franceze po mbërrijnë në Rumani si elementi kryesor i kësaj force. Angazhimi ynë për nenin 5, klauzola jonë e mbrojtjes kolektive, është e veshur me hekur. Ne do të sigurojmë dhe mbrojmë çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s. NATO është një Aleancë mbrojtëse. Ne nuk kërkojmë konflikt me Rusinë. Rusia duhet të ndalojë menjëherë luftën. Tërheqë të gjitha forcat e saj nga Ukraina dhe angazhohet me mirëbesim në përpjekjet diplomatike. Bota qëndron përkrah Ukrainës në thirrjen për paqe.”, tha

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

NATO mbështet Ukrainën por nuk do të jetë pjesë e konfliktit

Pas deklaratës në konferencën e përbashkët për shtyp Sekretari i Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg dhe Presidenti i Polonisë, Andrzej Duda që dhanë në bazën ajrore ushtarake në Lask në Poloni, ata iu përgjigjën pyetjeve të gazetarëve lidhur me mbështetjen e NATO-s për Ukrainën dhe sidomos për avionët luftarakë, që ajo ka kërkuar.

Pyetja e drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Stoltenberg, ishte nëse është pajisur Ukraina me këta avionë ose jo dhe nëse jo, a do t'i sigurohen ato, si dhe a do ta bëjë NATO të mundur që Ukraina të përdorë aeroportet apo bazat ajrore të NATO-s si për shembull, bazën ajrore Lask në Poloni.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, tha lidhur me këtë se: “NATO qëndron në solidaritet me Ukrainën”

dhe se “Aleatët e NATO-s i kanë imponuar Rusisë kosto të rënda për pushtimin e saj krejtësisht të pajustificuar dhe të pamatur të Ukrainës dhe ne do t'i mbajmë Rusinë dhe Bjellorusinë përgjegjëse për atë që po bëjnë duke mundësuar pushtimin rus të Ukrainës”. “Aleatët e NATO-s kanë vendosur kosto ndaj Rusisë duke zbatuar sanksione të ashpra. Ne në fakt i adresuam ato sanksione në bisedën telefonike me Presidentin Biden dhe Presidentin Duda, dhe liderë të tjerë të NATO-s dhe BE-së. Aleatët e NATO-s ofrojnë lloje të ndryshme të mbështetjes ushtarake si materiale, armë antitank, sisteme të mbrojtjes ajrore dhe lloje të tjera të pajisjeve ushtarake për Ukrainën, ndihmë humanitare dhe gjithashtu mbështetje financiare. Por NATO nuk duhet të jetë pjesë e konfliktit. NATO nuk do të dërgojë trupa në Ukrainë ose nuk do të lëvizë avionë në hapësirën ajrore të Ukrainës”, -tha ai dhe “më pas mendoj se i takon Presidentit Duda t'i përgjigjet pyetjes në lidhje me aeroplanët e mundshëm polakë që do të vihen në dispozicion të Forcave Ajrore të Ukrainës”, -tha Jens Stoltenberg.

Presidenti i Polonisë Andrzej Duda u përgjigj gjithashtu në të njëjtën linjë me Sekretarin e Përgjithshëm, Stoltenberg në lidhje me pyetjen e drejtuar nga gazetarët. “Ne nuk po dërgojmë asnjë avion në Ukrainë, sepse kjo do të hapte një ndërhyrje ushtarake në konfliktin ukrainas. Ne nuk po i bashkohemi atij konflikti. NATO nuk është palë në atë konflikt. Megjithatë, siç thashë, ne po mbështesim ukrainasit me ndihmë humanitare. Megjithatë, ne nuk do të dërgojmë asnjë avion në hapësirën ajrore të Ukrainës”, -tha presidenti polak Andrzej Duda.

NATO RRIT PRANINË NË KRAHUN LINDOR TË ALEANCËS

Njësitë e Forcave të Reagimit të NATO-s mbërrijnë në Rumani

Njësitë e Forcës së Reagimit të NATO-s mbërritën në Rumani të hënën dhe të martën (28 shkurt – 1 mars 2022), për të përforcuar pozicionin mbrojtës të NATO-s në pjesën lindore të Aleancës. 500 trupa franceze u grumbulluan në Istres, në Francën jugore përpara se të vendoseshin në Rumani. Kjo është hera e parë që NATO aktivizon Forcën e Reagimit të NATO-s për mbrojtjen kolektive dhe parandalimin. Ajo pason aktivizimin e planeve të saj të reagimit të mbrojtjes nga NATO, në mes të krizës më të madhe të sigurisë në Europë në dekada, të shkaktuar nga vendosja masive ushtarake e Rusisë dhe pushtimi i saj në Ukrainë. Franca kryeson elementin e gatishmërisë më të lartë të këtij viti të Forcës së Reagimit të NATO-s, një forcë

shumëkombëshe e përbërë nga deri në 40,000 personel tokësor, ajror, detar dhe të operacioneve speciale që NATO mund t'i vendosë në një njoftim të shkurtër sipas nevojës.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg përshëndeti vendosjen: “Gjatë javëve të fundit, ne kemi rritur praninë tonë në pjesën lindore të Aleancës dhe tani, për herë të parë në historinë tonë po vendosim Forcën e Reagimit të NATO-s. Trupat franceze kanë mbërritur në Rumani si elementi kryesor i kësaj force. Angazhimi ynë për nenin 5, klauzolën tonë të mbrojtjes kolektive, është i veshur me hekur. Ne do të sigurojmë dhe mbrojmë çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s.”



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s viziton grupin luftarak shumëkombësh në Estoni

NATO do të sigurojë dhe mbrojë çdo centimetër të territorit të saj

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua me Presidentin Alar Karis, më 1 mars 2022, në fillim të vizitës në Estoni. Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi Estoninë për kontributet e saj në NATO, si dhe mbështetjen e saj të fortë për Ukrainën, duke përfshirë ndihmën ushtarake dhe humanitare. Në Estoni Sekretari i Përgjithshëm vizitoi grupin luftarak shumëkombësh të NATO-s në Tapa, së bashku me kryeministren estoneze Kaja Kallas, kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar Boris Johnson, Kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s admiralin Rob Bauer dhe Komandantin Suprem të Aleatëve për Europë, gjeneralin Tod D. Wolters. Ata u takuan me personelin britanik, estonez, francez dhe islandez që shërbejnë në grupin luftarak. Sekretari i Përgjithshëm i vlerësoi ata për shërbimin e tyre, për mbrojtjen e Aleancës dhe vlerave të saj. Grupi luftarak udhëhiqet nga Mbretëria e Bashkuar dhe është një nga katër grupet e vendosura në rajon për të penguar agresionin dhe për të ruajtur paqen.

Sekretari i Përgjithshëm zhvilloi bisedime me kryeministren Kaja dhe kryeministrin Johnson për pushtimin e Ukrainës nga Rusia. Ai falënderoi Estoninë dhe Mbretërinë e Bashkuar për vendosjen e sanksioneve të forta ndaj Rusisë, rritjen e pranisë së NATO-s në të gjithë Aleancën dhe rritjen e mbështetjes për të ndihmuar Ukrainën të mbrohet. “Mesazhi ynë për Presidentin Putin është: ndaloni luftën, tërhiqni të gjitha forcat tuaja nga Ukraina dhe angazhohuni me mirëbesim në përpjekjet diplomatike; bota qëndron me Ukrainën”, -tha ai. Ai theksoi gjithashtu se aleatët do të sigurojnë dhe mbrojnë çdo centimetër të territorit të NATO-s dhe falënderoi Mbretërinë e Bashkuar për dyfishimin e pranisë së trupave të saj në grupin e betejës së NATO-s.”

NATO rrit pranimë mbrojtëse, në ajër, në tokë dhe në det

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, kryeministrja e Estonisë, Kaja Kallas dhe kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar Boris Johnson, mbajtën një konferencë të përbashkët për shtyp e në bazën ushtarake në Tapa në Estoni.

“Ne jemi këtu për të takuar ushtarët që mbrojnë Estoninë, Aleancën tonë dhe vlerat tona”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në deklaratën e tij. “Këta ushtarë po i mbajnë kombet tona të sigurta dhe të lira dhe ne u kemi një borxh mirënjohjeje. Faleminderit Estonisë që e priti kaq mirë grupin tonë të betejës, si dhe që është një aleate kaq e vendosur e NATO-s. Stoltenberg falënderoi Mbretërinë e Bashkuar dhe kryeministrin dhe Boris Johnson, për udhëheqjen e grupit të betejës shumëkombëshe të NATO-s në bazën Tapa, në Estoni dhe që e bënë këtë për pesë vitet e fundit dhe gjithashtu, për dyfishimin e kontributit tuaj gjatë javëve të fundit, me më shumë trupa britanike që vijnë në Estoni. Kjo me të

vërtetë bën një ndryshim të madh dhe demonstroi solidaritetin e NATO-s. Ne qëndrojmë së bashku në këtë kohë krize. Populli i Ukrainës po lufton me guxim kundër një pushtimi brutal dhe të paprovokuar rus. Ne e dënojmë plotësisht luftën e Kremlinit. Aleatët po i imponojnë Rusisë kosto të rënda përmes sanksioneve”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. “Ne po rrisim pranimë e NATO-s në të gjithë Aleancën, për të penguar dhe mbrojtur dhe ne po shtojmë mbështetjen tonë për të ndihmuar Ukrainën të mbrohet”, -tha ai. Aleatët

e NATO-s po i dërgojnë Ukrainës armë antitank, raketa të mbrojtjes ajrore dhe municione. Aleatët po ofrojnë gjithashtu ndihmë financiare dhe humanitare në vlerë prej miliona eurosh. Përgëzoj Estoninë dhe Mbretërinë e Bashkuar për ndihmën që po i ofroni Ukrainës”, -nënvizoi Stoltenberg.

“Gjatë javëve të fundit, në përgjigje të sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës, ne kemi rritur pranimë tonë mbrojtëse. Në ajër, në tokë dhe në det, me mbi 100 avionë në gatishmëri të lartë që operojnë nga 30 vende të ndryshme dhe

mbi 120 anije nga Deti Baltik në Mesdhe. Mretëria e Bashkuar, SHBA dhe aleatët tjerë po vendosin mijëra trupa të tjera në pjesën lindore të Aleancës. Për herë të parë në historinë tonë, ne po vendosim Forcën e Reagimit të NATO-s, sepse nuk duhet të ketë asnjë dyshim, vend për llogaritje të gabuara apo keqkuptime. Angazhimi ynë ndaj nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit është i veshur me hekur. Ne do të sigurojmë dhe mbrojmë çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s. Parandalimi i besueshëm parandalon konfliktin dhe ruan paqen.

NATO është një Aleancë mbrojtëse. Ne nuk kërkojmë konflikt me Rusinë. Mesazhi ynë për Presidentin Putin është: ndaloni luftën, tërhiqni të gjitha forcat tuaja nga Ukraina dhe angazhohuni me mirëbesim në përpjekjet diplomatike. Bota qëndron përkrah Ukrainës në thirrjen për paqe. Ne qëndrojmë së bashku në Aleancë, të bashkuar në dënimin tonë të pushtimit rus të Ukrainës.”

Pas përfundimit të deklaratës të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, gazetarët drejtuan pyetje për të tre liderët.

SULMI I RUSISË NDAJ UKRAINËS

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s pret në takim kryeministren e Islandës në Bruksel

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, priti në një takim kryeministren e Islandës, znj. Katrín Jakobsdóttir në Bruksel, për bisedime që kishin në qendër pushtimin e paprovokuar të Ukrainës nga Rusia.

Sekretari i Përgjithshëm përgëzoi kryeministren Jakobsdóttir për mbështetjen e Islandës për Ukrainën. “Jemi mirënjohës për kontributin që po jepni për sigurinë tonë të përbashkët. Si kur bëhet fjalë për ofrimin e mbështetjes për Ukrainën, por edhe zbatimin e sanksioneve dhe gjithashtu mbylljen e hapësirës ajrore islandeze”, -tha ai.

Islanda gjithashtu kontribuon në mbrojtjen dhe qëndrimin parandalues të NATO-s, duke pritur një mision të policisë ajrore të NATO-s, i cili siguron hapësirën ajrore në Atlantik dhe në Veriun e Lartë, si dhe duke vendosur një ekspert civil në grupin e betejës të udhëhequr nga Mbretëria e Bashkuar në Estoni.

“Islanda është me të vërtetë një mbështetëse e vendosur e Aleancës sonë. Ju jeni një anëtar themelues dhe ju luani një rol të rëndësishëm



për Aleancën tonë në shumë mënyra të ndryshme. Vendndodhja juaj strategjike, angazhimi juaj shumë i fortë ndaj vlerave tona thelbësore. Por gjithashtu duke ndihmuar në fakt për të lidhur Amerikën e Veriut dhe Europën së bashku. Gjithçka është e rëndësishme për ne. Dhe është veçanërisht e rëndësishme tani kur kemi momentin më kritik për sigurinë europiane në dekada. Që të siguroheni që Europa dhe Amerika e Veriut të qëndrojnë së bashku. Ne jemi mirënjohës për kontributin që po

jepni për sigurinë tonë të përbashkët, edhe kur bëhet fjalë për ofrimin e mbështetjes për Ukrainën, por edhe zbatimin e sanksioneve dhe gjithashtu mbylljen e hapësirës ajrore islandeze. Unë vërtet vlerësoj shumë të gjitha kontributet që po jepni për aleancën transatlantike dhe NATO-n”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg në deklaratën e tij në konferencën e përbashkët për shtyp që mbajti me kryeministren e Islandës, Katrín Jakobsdóttir.

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg dhe Kryeministrja Jakobsdóttir diskutuan gjithashtu rrugën drejt Samitit të NATO-s në qershor, ku

udhëheqësit e NATO-s do të miratojnë Konceptin e ri Strategjik. Ky dokument themelor do të përshkruajë detyrat themelore të sigurisë për Aleancën, si dhe sfidat dhe mundësitë me të cilat përballet në një mjedis sigurie në ndryshim. Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi Islandën për angazhimin e saj shumë të fortë ndaj vlerave thelbësore të NATO-s. “Islanda po ndihmon për të lidhur Amerikën e Veriut dhe Europën së bashku”, theksoi Sekretari i Përgjithshëm.



DISA MENDIME PËR ZHVILLIMIN E PUNËS DHE PROCESEVE NË ISKSHU

Në fokus, perspektiva e strukturës shkencore në FA (IKSHU) - rol i veçantë në fushën e kërkimit shkencor për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit

N/kol. (R) Mcs. KANAN HIMAJ*

Instituti i Kërkimeve Shkencore Ushtarake (IKSHU), është themeluar në Tetor 2019, si pjesë e Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA). IKSHU është e paracaktuar të veprojë në fushën e kërkimit të aplikuar, të ofrojë veprimtari shkencore, arsimore dhe të luajë rolin e këshilltarit dhe ekspertit për të mbështetur menaxhmentin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe autoriteteve të tjera kombëtare që merren me çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë.

Përvoja jonë njëvjeçare e IKSHU ka kryer veprimtari shkencore dhe kërkimore, rezultate të cilave janë analiza strategjike dhe studime mbi politikën e sigurisë, strategjinë ushtarake, burimet e alokuara për mbrojtjen, sigurinë dhe teknologjitë me ndikim në Forcat e Armatosura, por edhe në fusha të tjera të sigurisë.

Ambicia e Institutit të Kërkimeve Shkencore Ushtarake (IKSHU), është që t'i përgjigjet sfidave të mjedisit bashkëkohor të sigurisë duke zhvilluar, zbatuar dhe shpërndarë rezultatet e kërkimit shkencor, praninë aktive të kërkimit shkencor, por edhe duke u përfshirë në procesin arsimor në kuadër të AFA-së, me perspektivë ofrimin e ekspertizës për institucionet dhe organizatat me përgjegjësi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Fushëveprimi dhe aktivitetet kryesore lidhen me identifikimin dhe shpërndarjen e përhershme të gjetjeve shkencore, të dala nga qasjet analitike gjithëpërfshirëse, për të mbështetur vendimmarrjen strategjike si dhe për të kontribuar në zhvillimin e Forcave të Armatosura.

Planifikimi dhe zbatimet e programit vjetor 2021 ishte orientuar në drejtimin e përcaktuar të profilit të institucionit. Kjo i dha mundësi të krijojë eksperience e re në studimin dhe trajtimin e çështjeve përmes punës studimore, aktiviteteve të ndryshme të drejtuara të çështjet e ambientit të sigurisë, trajtimit të aspekteve më të mira në konceptimin për hartimin e dokumenteve të planifikimit të mbrojtjes dhe sigurisë, debatet dhe bisedat në tavolinat për tema të rëndësishme dhe specifike etj.

Për të parë më tej, ne theksojmë duhet të kuptohet se analiza e rezultateve të aktiviteteve kërkimore ka synim për të mbledhur gjetjet shkencore përkatëse të zbatueshme në kuadër të studimeve të mëtejshme specifike të sigurisë dhe strategjisë që mbulojnë mjedisin akademik, institucional, ndërqeveritar dhe aq sa mundemi për çështje ndërkombëtare.

Gjithashtu mendojmë se aktivitete në kuadrin e studimeve për ekspertë



civilë dhe ushtarakë, që veprojnë në fushën e mbrojtjes dhe vendimmarrjes strategjike, mbështetja e tyre të jetë këshilluese në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

Tashmë, misioni i IKSHU i nënshtrohet qëllimit më të gjerë të AFA-së, duke u bërë njësi e rëndësishme e njohurive dhe ekspertizës shkencore në fushën ushtarake e të sigurisë. Në këtë këndvështrim, perspektiva e tij kërkon të jetë maja e kërkimit shkencor në këtë fushë, duke promovuar aktivitete dhe një portofol mbresëlënës punimesh shkencore.

Mendojmë se ne duhet të shohim dhe besojmë për IKSHU, që ai të jetë mendimi shkencor për përpunimin ekspertizës për institucionet politiko-ushtarake në Shqipëri; arsyetimin e bazës teorike dhe funksioneve të komponentit ushtarak në dokumentet kryesore të procesit të planifikimit strategjik të vendit; vëzhgimi i ndryshimeve në evoluimin e mjedisit strategjik ushtarak me ndikim në interesat e Shqipërisë; eksplorimi i rolit të Forcave të Armatosura në mjedisin e ardhshëm operacional; studimi i dukurive brenda shoqërisë shqiptare me ndikim në fushën ushtarake; zhvillimi i bashkëpunimit me institutet kërkimore ushtarake dhe civile, struktura të tjera qeveritare dhe joqeveritare, brenda dhe jashtë vendit; promovimi i kulturës strategjike dhe të sigurisë në shoqërinë shqiptare dhe mbështetja e formimit profesional në nivel strategjik në kuadër të AFA-së, duke integruar rezultatet e kërkimit shkencor në procesin arsimor.

Në një përpjekje për të përmirësuar objektin, mendojmë se veprimtaria kërkimore-shkencore e IKSHU, do të jetë strukturë e orientuar në programimin e punës së saj, si më poshtë:

a. Për konceptet e sigurisë dhe mbrojtjes: thellimi teorik dhe zbatimi i koncepteve të avancuara në fushën e studimeve të sigurisë, shkencës ushtarake dhe disiplinave përkatëse.

b. Për sigurinë Euroatlantike: përshtatja ose përputhja e Procesit tonë të Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes me Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s (NDPP), analiza dhe thellimi i veprimeve të aktorëve kryesorë shtetërorë dhe organizatave kryesore ndërqeveritare në fushën e sigurisë.

c. Për Strategjinë Ushtarake: analiza dhe thellimi i teorisë dhe koncepteve strategjike dhe vlerësimi perspektiv i strategjisë ushtarake

d. Për Forcat e Armatosura të RSH: analizë e rolit të FA-së, doktrinës së saj, standardet dhe mësimet e nxjerra dhe profesionit ushtarakut në shoqërinë civile.

e. Fushat me interes strategjik: analiza e ngjarjeve dhe dukurive në fushat kryesore me interes strategjik, projeksionet dhe vlerësimet, organizatat e sigurisë, etj.

Gjithashtu, mendoj se përmirësimi i cilësisë së informacionit (analizës) për çështjet aktuale të agjendës rajonale dhe ndërkombëtare, që ndikojnë në interesat e Shqipërisë duhet të jetë pjesë e rëndësishme e kërkimit shkencor në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ajo t'i shërbejë përmbushjes së nevojës për të kuptuar dinamizmin dhe sigurinë e vendit, kompleksitetin e mjedisit të sigurisë, zhvillimin e sistemit të mbrojtjes së vendit dhe mbrojtjes kolektive.

Disa nga drejtimet e rëndësishme që zhvillohen dhe të formatojnë punën e IKSHU-së për periudhën afatmesme janë: hedhja e hapave të parë dhe zhvillimi i ekspertizës për institucionet politiko-ushtarake në Shqipëri; arsyetimi i metodës së procesit të planifikimit strategjik të mbrojtjes, si një nga detyrat kryesore e përshtatjes me hartimin e dokumenteve kryesore të planifikimit strategjik të vendit dhe në përshtatje me ato të NATO-s; vëzhgimi dhe vlerësimi i ndryshimeve që ndikojnë në mjedisin strategjik në përputhje me interesat

e Shqipërisë; vlerësimi, rishikimi i rolit të Forcave të Armatosura në mjedisin e ardhshëm operacional; studimi i dukurive brenda shoqërisë tonë me ndikim në fushën sigurisë dhe mbrojtjes; zhvillimi i bashkëpunimit me institutet kërkimore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, struktura qeveritare dhe joqeveritare, brenda dhe jashtë vendit; promovimi i kulturës të sigurisë në shoqërinë shqiptare; mbështetja e formimit profesional në nivel strategjik në kuadër të AFA-së, duke integruar rezultatet e kërkimit shkencor në procesin arsimor.

Aktivitetet e Institutit të Kërkimeve Shkencore Ushtarake (IKSHU), si një institucion i ri ka organizuar aktivitete të tilla si konferenca, seminare, tryeza të rrumbullakëta, mësimdhënie dhe leksione mbi mbrojtjen dhe sigurinë etj., të cilat do të vijojnë të paraqesin interes për temat aktuale dhe me interes të gjerë për sigurinë dhe mbrojtjen, me kushtin e vetëm të rritjes së cilësisë së tyre. Ato do të përfshijnë punime të ndryshme nga kërkuesit e institucionit, studiues, akademikë, ekspertë, studentë master dhe doktoratë duke u shndërruar në tribun të vërteta dhe reale në funksion të misionit.

Prandaj, nisja duket se është pozitive, ajo ka një pamje më të gjerë për të interesuarit dhe për të shpërndarë rezultatet progresive të veprimtarisë kërkimore-shkencore për sot dhe për të ardhmen. Nisur sa më lartë, për IKSHU është e rëndësishme hapja e botimit shkencor si brenda dhe jashtë vendit me akses të lirë, në shqip dhe anglisht.

Më konkretisht, publikimi si pjesë e misionit të IKSHU-së, më konkretisht, Revista Ushtarake do të vijojë të botojë analiza, sinteza dhe vlerësime të nivelit strategjik, por edhe këndvështrime në të cilat shqyrtohet ndikimi strategjik i dinamikës së veprimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe global. Vend

të rëndësishëm në tematikën e publikimeve mund të jenë: aktualiteti politiko-ushtarak; konceptet e mbrojtjes dhe sigurisë; tendencat dhe perspektivat në fushën e gjeopolitikës dhe gjeostrategjike; strategjia e sigurisë dhe mbrojtjes; politikat, strategjitë, veprimet e NATO-s dhe BE-së; dinamika e mjedisit të sigurisë dhe dialogu strategjik, etj. Publikimi do të jenë për mundësitë e botimeve elektronike në faqen elektronike të IKSHU-së si artikuj shkencorë, të cilët janë rezultat i analizave dhe studimeve kërkimore, si dhe sinteza të ngjarjeve shkencore apo përfundimeve të projekteve kërkimore. Kontribuuesit kryesorë të botimit janë kërkuesit, analistë, studiues, studentë master, studentë të doktoratës dhe specialistë të tjerë të përfshirë në kërkimin shkencor në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Duam të theksojmë se publikimet dhe botimet duhet t'i nënshtrohen një analize anti-plagjiaturë, ato vlerësohen shkencërisht nga një panel studiuesish dhe pedagogë, sipas procesit të rishikimit të dyfishtë i errët.

Për sa më lart, punimet me ndikim strategjik në IKSHU duhet të përfshijë bashkëpunëtorët e tij, personalitete të shquara në fushën e kërkimit shkencor dhe të arsimit të lartë ushtarak e civil, në strukturat e FA-së, dhe institucionet e tjera shtetërore, organizatat joqeveritare, etj.

Nisur nga misioni i IKSHU, mund të adresohen sfidat e zhvillimit të fenomenit strategjik bashkëkohor, mjedisit të sigurisë dhe shkencave ushtarake në tërësi, duke zbatuar dhe shpërndarë njohuritë kërkimore. Kështu, IKSHU mund dhe duhet të ofrojë analiza objektive, rigorozë dhe në kohë, të destinuara si për vendimmarrësit në MM/SHPFA dhe institucionet e tjera me përgjegjësi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, ashtu edhe për procesin e edukimit strategjik (mësimdhënien në AFA), në kuadër të AFA-së.

Në përfundim mund të theksojmë se puna dhe përvoja e deritanishme, është bazë e shëndoshë për hapa të mëtejshëm në punën shkencore dhe inovacionin në FA. Ajo do të përmbajë nivelin e lartë shkencor dhe intelektual në punën e saj, duke parë gjithnjë aspektet e reja të proceseve të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit. Përmirësimi dhe vendosja në fokus çështjet thelbësore të problematikës që lidhet me punën e institucionit, do të sjellë aspekte pozitive në punën e gjithsecilit.

*Specialist Kërkimi,
Departamenti i Kërkimit për Strategjinë dhe Sigurinë (IKSHU)



Në këtë takim u bisedua për mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit në fushën e mjekësisë ushtarake si dhe nënshkrimin e një protokoli të bashkëpunimit mes të dy shërbimeve respektive. Gjithashtu, gjatë takimit, kolonel Dr. Tahiraj, i kërkoi homologut të tij, meqë Shqipëria është anëtare e NATO-s, që të shprehë ndikimin e tij te autoritetet e tjera, që Shërbimi Mjekësor i FSK-së të anëtarësohet në organizatat e mjekësisë ushtarake.



Rritet bashkëpunimi në fushën e mjekësisë ushtarake mes FARSH dhe FSK

Rritet bashkëpunimi në fushën e mjekësisë ushtarake mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në kuadër të bashkëpunimit bilateral mes FSK-së dhe FARSH-it, drejtori i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë e Mbrojtjes, kolonel Dr. Xhevdet Tahiraj, i shoqëruar nga major Dr. Kadri Haradinaj qëndruan për vizitë dyditore në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vizitës në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Kolonel Dr. Tahiraj u prit nga drejtori i Inspektoratit të Shëndetësisë, kolonel Dr. Elton Reso. Në këtë takim u bisedua për mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit në fushën e mjekësisë ushtarake si dhe nënshkrimin e një protokoli të bashkëpunimit mes të dy shërbimeve respektive. Gjithashtu, gjatë takimit, kolonel Dr. Tahiraj, i kërkoi homologut të tij, meqë Shqipëria është anëtare e NATO-s, që të shprehë ndikimin e tij te autoritetet e tjera, që Shërbimi Mjekësor i FSK-së të anëtarësohet në organizatat e mjekësisë ushtarake.

Më pas, kolonel Dr. Tahiraj dhe major Dr. Haradinaj, vizituan Komandën e Forcave Tokësore, ku u pritën nga komandanti i saj, gjeneral brigade Arben Kingji, në Komandën e Forcave Ajrore, nga gjeneral brigade Ylli Pulaj, si dhe në Komandën e Forcave Detare, nga kolonel Ferdinand Kreshpani.

Përveç me këto autoritete respektive, në këto takime, delegacioni ynë u takua edhe me shefat e mjekësisë se këtyre tri forcave.

Gjatë këtyre takimeve, palët diskutuan për format dhe fushat specifike të mjekësisë ushtarake të bashkëpunimit konkret me theks të veçantë, në shkëmbimin e përvojave dhe mbështetjen e ndërsjellë.

Kjo vizitë u vlerësua shumë e suksesshme dhe së shpejti pritet të zyrtarizohet me protokollin e bashkëpunimit mes dy komponentëve shumë të rëndësishme të forcave të dy vendeve.



Presidenti Recep Tayyip Erdoğan premtan mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në NATO

Presidenti Recep Tayyip Erdoğan në takimin me ftesën e tij, me Presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, ka dhënë përkrahjen e Turqisë për anëtarësimin e Kosovës në NATO.

Gjatë konferencës së përbashkët për media, pas firmosjes së disa marrëveshjeve mes dy vendeve, Osmani ka falënderuar Turqinë që gjithmonë i ka qëndruar Kosovës pranë dhe ka thënë se shpreson që Turqia, si vend me ndikim në NATO, të ndihmojë në procesin e anëtarësimit të Kosovës në këtë aleancë.

“Situata në Ukrainë ka treguar për nevojën që Kosova të anëtarësohet në NATO, në një aleancë ku Turqia ka ndikim të madh. E falënderoj presidentin Erdogan për përkrahjen në këtë drejtim”, -tha Osmani. “Duke na përkrahur për t’u anëtarësuar në NATO, Turqia i jep përkrahje të drejtpërdrejtë paqes e sigurisë në gjithë rajonin dhe në kontinentin e Europës”.

Osmani sërish ka thënë se Rusia nëpërmjet Serbisë po synon ta destabilizojë Ballkanin Perëndimor.

“Serbia nëpërmjet strukturave ilegale në veri të Kosovës nuk po synon ta destabilizojë vetëm Kosovën por gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor”, -tha Osmani.

Erdogan në anën tjetër tha se do ta ndihmojë Kosovën për anëtarësim në NATO, siç e ka ndihmuar për të siguruar njohje të reja.

“Turqia ishte vendi i dytë që e njohu Kosovën. Me zonjën Osmani u bisedua për disa vende që ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe për të parë për njohje të reja. Ne si vend i rëndësishëm në NATO nuk



shohim asgjë që nuk shkon sa i përket anëtarësimit të Kosovës në këtë aleancë dhe për të mbështetur këtë proces. Do të ndërmarrim hapat tona, siç ndihmuam në procesin e njohjeve do të bëjmë njëjtë edhe në procesin e anëtarësimit të Kosovës në NATO”, -tha Erdogan.

Ai në anën tjetër po ashtu ka thënë se shpreson të përforcohet edhe më tej bashkëpunimi mes Kosovës e Turqisë në të gjitha sferat, ndërsa ka folur edhe për dialogun Kosovë – Serbi.

“Turqia dëshiron të zhvillojë marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët e saj. Dëshira jonë e sinqertë është që procesi i dialogut me Serbinë të përfundojë sa më shpejt me marrëveshje gjithëpërfshirëse që do të sigurojë stabilitetin në rajon”, -tha Erdogan.

Osmani sa i përket dialogut tha se Kosova ka qenë gjithmonë e gatshme për dialog e në qendër të saj të jetë njohja e ndërsjellë. Ajo ka thënë se Kosova ka ofruar disa propozime në tavolinë të dialogut por janë refuzuar nga pala serbe.

Erdogan gjatë konferencës përmendi edhe organizatën FETO. Tha se është me rëndësi që kjo organizatë të shuhet dhe se ia ka shprehur Osmanit pritshmërinë për ndihmën në këtë aspekt.

U nënshkruan sot tri marrëveshje bashkëpunimi në fushën e Rinisë dhe Sportit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Turqisë, një në fushën e pylltarisë dhe një memorandum mirëkuptimi për protokollin ndërmjet ministrive të Jashtme.

“Nëse nuk kemi paqe, kjo ndodh për shkak se kemi harruar që i përkasim njëri-tjetrit”

(Nënë Tereza)

PUNOI: SHEFE E SEKTORIT
TË BOTIMEVE,
ANJEZA MUSOLLARI

Ka ngjarje mbi të cilat koha nuk ka fuqi. Dhe sa më tej shkojnë vitet, aq më e qartë bëhet madhështia e tyre. Ngjarje të tilla përfshijnë Luftën e Madhe. Për ne është e rëndësishme të ruajmë kujtimin e luftës, për gjithçka të dhimbshme që la pas. Ajo jetonte në libra, histori gjyshërisht, dokumente, fotografi, letra, zemra, por me sa duket një përbindësh i zi herë pas here e shkund tokën, për të na risjellë para syve atë që vetëm mes gojëdhënave kemi kuptuar se çfarë tmerrri është.

Shpeshherë, janë bërë luftëra të përgjakshme, të cilat kanë sjellë pasoja mjaft të rënda: pasoja psikologjike dhe pasoja fizike të cilat nuk kanë qenë të pakta. Liderët shpesh mundohen të gjejnë pretekste ose ‘fakte’ për nisjen të luftës së parë botërore, ku pati shumë vdekje dhe humbje.

Por, përse niset një luftë? Njeriu, një qenie komplekse. Një qenie, e cila s’di të ndalet përpara vështirësive që i hasen rrugës në përmbushjen e synimeve të tij. Por shpesh herë, rruga që ndjekin këto synime është katastrofike. Dëshira e njeriut të pangopur e të babëzitur për territore e pasuri natyrore, ka çuar në zhvillimin e luftërave. Kjo i ka fillesat qindra, e ndoshta mijëra vjet më parë. Njerëzit ndër shekuj kanë luftuar ndërmjet tyre. E quanim veten, qenia më e zhvilluar në planet. Por ku shihet zhvillimi kur ti lufton kundër sojit tënd? Kur ti ke guximin të vrasësh një qenie pa asnjë ndryshim nga ty, a nuk mendon se po vret një pjesë të njerëzimit? Ndoshta edhe një gjeneratë të ardhshme që mund të sjellë ndryshimin në këtë botë. Por lakmia e dëshira për pushtet duket se ka pushtuar shpirtin e shumë prej nesh. E kur shohim dëmet katastrofike, të bëra me vetëdije, shpesh herë na shfaqet paqja. Duket se ajo lind nga lufta, është ajo shpresa e vogël e njerëzimit për të rregulluar gabimet e tij. Këto dy dukuri, shpesh ndodhin për të përfituar më shumë pasuri ose për të marrë atë që nuk i takon, sepse raca njerëzore asnjëherë nuk mjaftohet me atë që zotëron, por kërkon gjithnjë e më shumë, pavarësisht pasojave që mund të ketë kjo. Madje pa u stepur edhe deri në eliminimin e llojit të vet.

Kush janë liderët e sotëm? Të gjithë ne vijmë në këtë jetë jo si të rritur, jo si banditë dhe jo si virypte. Një burrë i vogël shfaqet... jo në botë, por deri më tani vetëm në barkun e nënës së tij. Në fakt, ai është vetëm një koleksion qelizash të trashëguara nga prindërit e tij. Por, megjithatë, ky është tashmë një i rritur i ardhshëm. Ai është në gjendje të perceptojë, thithë informacionin



nga jashtë. Nëse ky është një fëmijë i planifikuar, i shumëpritur, atëherë që nga momenti i konceptimit ai është i rrethuar nga dashuria prindërore. Pak më vonë, një person i vogël fiton aftësinë për të dëgjuar dhe dalluar intonacionet. Pa dyshim, fjalët e kujdesshme dhe të buta kanë një efekt pozitiv në psikikën e sapolindur. Një fëmijë rritet që në moshën embrionale, duke kuptuar se kjo botë është e bukur, e mbushur me dashuri, mëson t’i besojë atij dhe t’i përgjigjet. Nuk është e vështirë të imagjinohet se si urrejtja dhe vrazhdësia nga të tjerët dhe, para së gjithash, nga vetë nëna, ndikojnë tek fëmija që rritet në bark. Një person i ri - ai është i pastër si një çarçaf i bardhë. Ai thjesht ekziston, ai thjesht jeton në botën e tij të vogël, të ngushtë, duke e njohur botën e jashtme të madhe përmes nënës së tij, nëpërmjet babait të tij, përmes dikujt tjetër të afërt. Ekziston një sasi e caktuar e kujtesës gjenetike, por edhe nëse është negative, është e mundur të drejtoni një mendje të pa zgjuar në një drejtim pozitiv. Por çfarë ndodh me tjetërsimin e njeriut gjatë rrugëtimit të tij? Lider bëhesh, nuk lind, dhe mesa duket për të arritur deri këtu egoja e disa njerëzve në kulmin e narcizmit humbasin çdo vlerë të bukur e njerëzore që gëzonin. Ftohtësia e ndjenjave dhe epshi urrejtës i egos për të arritur qëllimet e ‘ëndrrave të zeza’, jo rrallë na kanë sjellë në vëmendje liderë që rruzullin po e sjellin rrotull.

Çfarë pasojash sjell lufta për ne? E thjeshtë, vuajtje! Por kjo gjë nuk ndodh vetëm nga ana materiale, por dhe nga ana fizike e psikologjike. Shumë autorë të brezit të humbur kanë pasur vështirësi psikologjike nga lufta. Njëri prej tyre

ishite Petro Marko, i cili e përshkruan me detaje në romanin e tij “Nata e Ustikës”. Ai e përshkruan luftën si ‘nata e errët dhe e frikshme e cila mbështjell këdo me frikë dhe mjegull të mistershme. “Ne e njohim fytyrën e saj, si fytyrën e nënës, po ajo a do të na njohë? Se ne po kthehemi nga ferri dhe ferri, ndoshta na ka shpërfytyruar...”

A është lufta fataliteti i jetës njerëzore? Lufta është një nga fatalitetet e jetës njerëzore, por nuk është shkaktari i vërtetë i saj. Lufta nuk është shkaktari i vërtetë i fatalitetit të jetës së njeriut, lufta nis nga lakmia. E keqja e çdo njeriu është lakmia për pasurinë e tjetrit, lakmia për pushtet absolut. Por prapë natyra e njeriut krijohet nga edukimi i tij. Lufta sjell humbje të cilat sjellin urrejtje, hak-

jetës njerëzore! Lufta, tashmë jo përfytyrim por realitet është e pranishme me frymën e saj urrejtëse, shkatërrim, dhimbje, gjak, lot. Është e lehtë për ta filluar një luftë, por mjaft e vështirë për ta shmanjur dhe për t’i dhënë fund asaj.

Pse duhet të jetojmë në luftë? Si mund të jenë disa prej nesh aq mizor sa të zgjedhin luftën në vend të paqes? Si mund të ekzistojnë njerëz që derdhin gjakun e të pafajshmëve, njerëz që copëtojnë shpirtin e njerëz që shkatërojnë ëndrra. Lufta është e tillë, e pamëshirshme, e përgjakshme.

Lufta shkakton vuajtje, dhimbje dhe zhgënjim. Lufta kurrë nuk mund të jetë një zgjidhje, po, ne mundemi t’i themi ndal asaj?!

Dikur një aktor, me impakt të fuqishëm për artin e tij, në shtetin që e



marrje, lakmi dhe gjithçka fillon nga e para, duke krijuar kështu luftëra të tjera. Ndoshta në të vërtetë shkaktari i vetëm i fatalitetit të jetës së njeriut është vetë natyra njerëzore. Lufta, fataliteti i

zgjedhi për ta drejtuar si liderin e vet Zelensky. Lideri që po i tregon botës se ende ka djem që flijohen për atdhe. Sytë tanë janë drejtuar drejt Ukrainës e cila na zgjoi nga “ëndrrat me luftë”,

për të luftuar realisht në emër të jetës.

“Ne jemi në tokën tonë, ne kemi të vërtetën, ato nuk mund të shkatërrojnë karakterin tonë. Raketat ruse “Kalibr” janë të pafuqishme kundër lirisë sonë”, -Zelensky.

Raca njerëzore me kokë të majme një ditë do të bindet se nuk ka mjerim dhe fatkeqësi më të madhe se lufta, dhe nga vuajtjet e saj një ditë do të mësohet se duhet ta shfuqizojë atë si një mjet shumë i shtrenjtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në luftë gjithçka është barbarizëm. Por barbaria më e keqe e luftës është ajo që i detyron njerëzit të gjithë së bashku të ndërmarrin veprime kundër të cilave ata individualisht do të rezistonin me të gjitha forcat.

Në paqe, bijtë varrosin etërit e tyre. Në luftë, etërit varrosin bijtë e tyre. Bota po mpaket, mendjet e nxehta, pa arsye dhe ndjenja po prishin ekuilibrat e jetës.

Bij të nënave! Mos e jepni vetveten te këta njerëz jo natyrorë, njerëz makina me mendje makine e zemra makine! Ju nuk jeni makina! Ju jeni njerëz! Ju keni dashurinë e njerëzimit në zemrat tuaja! Ju nuk urreni! Vetëm të pa dashuruarit dhe jo natyrorët urrejnë! Njerëz! Mos luftoni për skllavëri! Luftoni për liri!

Në emër të demokracisë, le ta përdorim këtë fuqi, le të bashkohemi të gjithë! Le të luftojmë për një botë të re, një botë të mirë që do t’i japë njerëzimit mundësinë të punojë, që do t’i japë rinisë një të ardhme dhe të moshuarve siguri. Duke premtuar këto gjëra, bishat janë ngritur në pushtet. Por ata gënjejnë! Ata nuk i përmbushin këto premtime. Kurrë nuk do t’i përmbushin!

Diktatorët lirojnë vetveten e tyre, por skllavërojnë popullin! Tani le të luftojmë ta përmbushim atë premtim! Le të luftojmë që ta lirojmë botën, t’i largojmë barrierat, të largojmë lakminë, urrejtjen e intolerancën. Le të luftojmë për një botë të arsyeshme, një botë ku shkenca dhe progresi do të na shpënë te lumturia e të gjithë njerëzve.

Ne duam të jetojmë nga lumturia e njëri-tjetrit, jo nga mjerimi i njëri-tjetrit. Ne nuk duam të urrejmë apo të përçmojmë. Në këtë botë ka vend për të gjithë. Dhe Toka e mirë është e pasur dhe ofron për të gjithë. Jeta mund të jetë e lirë dhe e bukur, por ne e kemi humbur rrugën.

Njerëz! Në emër të demokracisë, le të bashkohemi për fëmijët tanë, për t’i thënë ndal kujtdo që ngre dorë mbi ta!!”

Eurodeputetët: Sulmi rus ndaj Ukrainës shënon një epokë të re për Europën

Zelenskyy: “Provojeni se jeni me ne! Vërtetoni se jeni me të vërtetë europianë dhe atëherë jeta do të fitojë mbi vdekjen dhe drita do të fitojë mbi errësirën. Lavdi Ukrainës!”

Eurodeputetët shprehën mbështetjen e palëkundur për Ukrainën dhe për përpjekjet për ta sjellë vendin më afër komunitetit europian.

Të martën, Parlamenti European mbajti një seancë të jashtëzakonshme plenare në Bruksel, për të vlerësuar sulmin ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy dhe kryetari i parlamentit ukrainas, Ruslan Stefanchuk folën drejtpërdrejt nga Kievi. Në diskutim morën pjesë edhe presidentët e Këshillit European dhe Komisionit, Charles Michel dhe Ursula von der Leyen, si dhe shefi i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell.

Në hapjen e diskutimeve, Presidentja e Parlamentit European, Roberta Metsola tha: “Ne jemi sot këtu në hijen e errët të hedhur nga lufta e Putinit. Një luftë që ne nuk e provokojmë. Një luftë që ne nuk e filluam. Një pushtim i egër i një shteti sovran e të pavarur. Në emër të Parlamentit European, dënoj agresionin ushtarak rus kundër Ukrainës në terma të fortë të mundshëm dhe shpreh solidaritetin tim me të gjithë ata që vuajnë dhe të gjithë të varurët.

“Ne do të ngrihemi në këmbë. Ne nuk do të shikojmë larg kur ata që luftojnë në rrugë për vlerat tona të përballen me makinën masive të luftës të Putinit. Ne do të mbështesim juridiksionin dhe hetimin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për krimet e luftës në Ukrainë. Ne do t'i kërkojmë llogari”, -shtoi ajo.

Zelenskyy i bën thirrje BE-së të provojë se qëndron me Ukrainën

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy tha “në një ndërprerje mes sulmeve rakitore”, se Parlamenti dhe liderët e BE-së tani duhet të dëshmojnë se BE-ja është me Ukrainën. “Unë flas sot në emër të qytetarëve të Ukrainës që po e mbrojnë atë duke paguar çmimin përfundimtar”, -vazhdoi ai.

Zelenskyy iu referua sulmit në Kharkiv, qyteti me sheshin më të madh në vend, i quajtur “Sheshi i Lirisë”. “Sot në mëngjes dy raketa goditën “Sheshin Liria”, me dhjetëra të vrarë. Ky është çmimi që po paguajmë për lirinë tonë. Tani e tutje, çdo shesh në çdo qytet të Ukrainës do të quhet “Sheshi i Lirisë”.

Ne po luftojmë për të drejtat tona, liritë tona, jetën tonë, dhe aktualisht, për mbijetesën tonë. Ne po luftojmë gjithashtu për të qenë anëtarë të barabartë të Europës. Pra, tani provoni se jeni me ne”, -u tha ai eurodeputetëve. “Vërtetoni se jeni me të vërtetë europianë dhe atëherë jeta do të fitojë mbi vdekjen dhe drita do të fitojë mbi errësirën. Lavdi Ukrainës”.

Kryetari i parlamentit ukrainas Stefanchuk u tha eurodeputetëve: “Ukraina po mbron kufirin e botës së qytetëruar dhe nëse Ukraina bie, askush nuk e di se ku do të ndalen rusët”. Ai këmbënguli se mënyra më e mirë për të mbështetur Ukrainën është një njohje reale e aspiratave europiane të ukrainasve.

“Ky pushtim brutal, masiv i Ukrainës është i pajustifikuar, i paprovokuar dhe bazohet në gënjeshtër të neveritshme, dhe ndodh vetëm për



Eurodeputetët diskutuan për pushtimin rus të Ukrainës me presidentin e Ukrainës Volodymyr Zelenskyy



një arsye: sepse në sheshin Maidan, ju bëtë zgjedhjen e lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit”, -tha presidenti i Këshillit European, Charles Michel, duke e quajtur pushtimin e presidentit rus Vladimir Putin “terrorizëm gjeopolitik”. Ai i siguroi eurodeputetët se Këshilli do të analizojë kërkesën serioze, simbolike, politike dhe, sipas tij legjitime, të Ukrainës për t'u anëtarësuar në BE.

Presidentja e Komisionit European Ursula von der Leyen tha: “Ky është një moment i së vërtetës për Europën. Kjo është një përplasje midis shtetit ligjor dhe shtetit të armës, midis një rendi të bazuar në rregulla dhe agresionit të zhveshur. Ne nuk mund ta marrim si të mirëqenë sigurinë tonë, duhet të investojmë në të”. Ajo nënvizoi se “nëse Putin po kërkon të përçajë BE-në, NATO-n dhe komunitetin ndërkombëtar, ai ka arritur pikërisht të kundërtën”.

“Për të bërë paqe, duhet të jemi dy; por për luftë, mjafton me një, siç ka treguar zoti Putin. Kjo është arsyeja pse ne duhet të rrisim shumë kapacitetin tonë parandalues, për të parandaluar luftën”, -tha shefi i politikës së jashtme



të BE-së, Josep Borrell. “Mbrojtja e shtetit ligjor dhe forcimi i marrëdhënieve tregtare nuk do të mjaftojnë për ta kthyer botën në një vend paqësor”, -shtoi ai.

Një epokë e re ka filluar

Të gjithë drejtuesit e grupeve të PE-së morën fjalën, përkatësisht: Manfred Weber (EPP, DE), Iratxe García Pérez (S&D, ES), Stéphane Séjourné (Rinovo, FR), Philippe Lamberts (Greens/EFA, BE), Marco Zanni (ID, IT), Ryszard Antoni Legutko (ECR, PL) dhe Manon Aubry (The Left, FR).

Gjatë debatit, shumë eurodeputetë theksuan se si pushtimi rus i Ukrainës shënon fillimin e një epoke të re për Europën dhe botën. Ata dënuan presidentin rus Vladimir Putin dhe agresionin brutal të Kremlinit dhe shprehën admirimin e tyre për mënyrën sesi ushtria dhe populli ukrainas po i rezistojnë sulmit, duke luftuar për vendin e tyre, lirinë, demokracinë dhe vlerat e përbashkëta europiane.

Ata gjithashtu përshëndetën reagimin e fortë të Europës ndaj sulmit të paligjshëm, siç janë paketat e miratuara

të sanksioneve, ndërsa theksuan nevojën për të qëndruar të bashkuar për të vazhduar përballjen me sfidat serioze përpara.

Disa anëtarë mbrojtën njohjen e aspiratave europiane të Ukrainës dhe luftën për liri duke rritur punën e BE-së për t'i dhënë vendit statusin e kandidatit për në BE. Të tjerë theksuan rëndësinë e trajtimit të përbashkët të pasojave që sanksionet ndaj Rusisë do të kenë në një ekonomi europiane që ende po rimëkëmbet nga një pandemi globale, nëpërmjet sigurimit të mbështetjes për vendet më të prekura, si dhe për bizneset dhe qytetarët. Së fundi, disa vunë në dukje nevojën për të mirëpritur ukrainasit që ikin nga lufta dhe të gjitha vendet e BE-së që ndajnë atë përgjegjësi.

....nëse ka vend vendose këtë poshtë, nëse jo lëre.....

Komisioni European propozon mbrojtje të përkohshme për njerëzit që ikin nga lufta në Ukrainë dhe udhëzime për kontrollat kufitare

Komisioni propozon aktivizimin e Direktivës së Mbrojtjes së Përkohshme për të ofruar ndihmë të shpejtë dhe efektive për njerëzit që ikin nga lufta në Ukrainë. Sipas këtij

propozimi, atyre që ikin nga lufta do t'u jepet mbrojtje e përkohshme në BE, që do të thotë se do t'u jepet një leje qëndrimi dhe do të kenë akses në arsim dhe në tregun e punës.

Në të njëjtën kohë, Komisioni po parashtron gjithashtu udhëzime operacionale që synojnë të ndihmojnë rojet kufitare të Shteteve Anëtare në menaxhimin efikas të mbërritjeve në kufijtë me Ukrainën, duke ruajtur një nivel të lartë sigurie. Udhëzimet rekomandojnë gjithashtu që shtetet anëtare të krijojnë korsi të posaçme mbështetëse emergjente për të kanalizuar ndihmën humanitare dhe të kujtojnë mundësinë e dhënies së aksesit në BE për arsye humanitare.

Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen, tha: “Evropa qëndron pranë atyre që kanë nevojë për mbrojtje. Të gjithë ata që ikin nga bombat e Putinit janë të mirëpritur në Europë. Ne do të ofrojmë mbrojtje për ata që kërkojnë strehim dhe do t'i ndihmojmë ata që kërkojnë një rrugë të sigurt për në shtëpi.”

Nënkryetari për Promovimin e Mënyrës Evropiane të Jetesës, Margaritis Schinas, tha: “Në një vepër historikisht të paprecedentë, Komisioni sot po propozon dhënie mbrojtjeje së menjëhershme në BE për ata që ikin nga Ukraina. Të gjithë ata që ikin nga lufta do të kenë një status të sigurt dhe qasje në shkolla, kujdes mjekësor dhe punë. Në të njëjtën kohë, ne po punojmë për të lehtësuar kalimet efikase në kufi për njerëzit dhe kafshët e tyre shtëpiake, me kontrollat e nevojshme të sigurisë. Kohët po rëndojnë shumë mbi ne, por Bashkimi European dhe çdo shtet anëtar i tij po tregojnë pa dyshim se ne jemi gati të ngrihemi në pjatë dhe të solidarizojmë Ukrainën.”

Komisionerja për Punët e Brendshme, Ylva Johansson, tha: “Jam krenare për mënyrën sesi BE dhe Shtetet Anëtare po japin mbështetje të menjëhershme për ata që vijnë nga kërcënimet e tmerrshme të luftës. Me propozimet tona sot, ne do t'u japim vendeve anëtare kapacitete të mëtejshme për të menaxhuar këtë krizë në mënyrë të rregullt dhe efektive. Ne do t'u japim të drejta qëndrimi, akses në tregun e punës dhe strehim njerëzve në nevojë dhe së fundi me udhëzimet do të sigurohemi që ata që ikin nga lufta në Ukrainë të mund të arrijnë në BE shpejt, pa kaluar nëpër formalitete të gjata në kufij.

Vendosja e qytetarëve në zemër të Europës, Samiti European i Rajoneve dhe Qyteteve mbledh 2000 liderë në Marsejë

Udhëheqësit lokalë të BE-së miratojnë deklaratën e Ukrainës

Në një moment vendimtar për Europën, Komiteti European i Rajoneve dhe Rajoni Provence-Alpes-Côte d'Azur, mirëpritën 2000 liderë ndërkombëtarë, kombëtarë, lokalë dhe rajonalë në Marsejë, më 3-4 mars. Samiti i 9-të European i Rajoneve dhe Qyteteve organizohet në kuadër të presidencës franceze të Këshillit të BE-së. Në sfondin e pushtimit rus të Ukrainës, liderët lokalë dhe rajonalë të BE-së shprehën zyrtarisht mbështetjen e tyre për popullin ukrainas. Ata gjithashtu ndanë vizionin e tyre për Europën, duke bërë thirrje për forcimin e themeleve demokratike të BE-së dhe ndryshimet thelbësore, në mënyrë që të pajisë më mirë komunitetet lokale për t'iu përgjigjur sfidave të tilla si: ofrimi i kujdesit shëndetësor, fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimatike dhe pabarazitë territoriale.

Politikanët e zgjedhur vendorë dhe rajonalë miratuan kërkesat e tyre përfundimtare për Konferencën për Ardhmërinë e Europës në formën e një “Manifesti të autoriteteve rajonale dhe lokale për demokracinë europiane”, i cili nënvizon se funksionimi demokratik i BE-së kërkon përfshirje më të madhe të rajoneve, qyteteve dhe fshatrave, si dhe forcim të angazhimit demokratik të qytetarëve dhe të rinjve në veçanti. Fokusi do të jetë në ndërtimin e një rikuperimi gjithëpërfshirës pas krizës Covid-19, forcimi i kohezionit territorial dhe social në Europë dhe mbështetja e tranzicionit të gjelbër dhe dixhital. Presidenti i Komitetit European të Rajoneve, Apostolos Tzitzikostas, tha: “Ky samit në Marsejë mbledh mijëra liderë europianë kundër pushtimit brutal të Ukrainës nga Rusia. Udhëheqësit do të qëndrojnë së bashku në solidaritet, për paqen, demokracinë, dialogun, të drejtat themelore për popullin e Ukrainës dhe do të diskutojnë se si t'u ofrohet atyre ndihmë konkrete. Është një mundësi për të riafirmuar se sfidat kryesore: siguria, mbrojtja e të drejtave të njeriut, emergjenca klimatike, shërbimet publike dhe pabarazitë rajonale, kanë nevojë për unitet europian dhe përgjigje të përbashkëta europiane, që fillojnë në rajonet, qytetet dhe fshatrat tona. Samiti ka të bëjë me përmirësimin e demokracisë europiane, kështu që mbron, mbështet dhe përmirëson jetën e çdo qytetari brenda dhe jashtë kufijve të BE-së, duke e sjellë atë më pranë njerëzve.”

Renaud Muselier, President i Rajonit Provence-Alpes-Côte d'Azur dhe nënkryetar i Rajoneve të Francës, tha: “Në një kohë kur lufta është në pragun tonë, ne duhet të pohojmë fuqishëm se e duam Europën, kemi nevojë për Europën dhe Europa na mbron. Rajoni ynë ka dashur ta kthejë Europën në qendër të zhvillimit ekonomik, mjedisor dhe dixhital. Samiti i 9-të i Rajoneve dhe Qyteteve është i një natyre të veçantë. Dëshiroj të falënderoj Presidentin Tzitzikostas dhe Komitetin European të Rajoneve për cilësinë e punës që po kryejmë së bashku në këtë moment vendimtar. Territoriet europiane, kryetarët e bashkive, presidentët rajonalë dhe përfaqësuesit e zgjedhur vendorë, me Europën afër zemrës së tyre, nevojiten tani më shumë se kurrë, për të ndërtuar të ardhmen e demokracisë europiane të decentralizuar. Ata mishërojnë më së miri projektin europian, ndaj le t'i fuqizojmë! Përtej këtij Samiti, ne duhet të sigurojmë suksesin e Presidencës Franceze të Bashkimit European. Franca duhet të jetë motori që Europa të arrijë rezultate dhe arritje të mëdha”.



Samiti dyditor u hap nga Presidenti Tzitzikostas, Presidenti Renaud Muselier, Jacqueline Gourault, Ministri francez për Kohezionin Territorial dhe Marrëdhëniet me Autoritetet Lokale dhe Rajonale, Clément Beaune, Sekretari Francez i Shtetit për Çështjet Europiane, Martine Vassal, Presidentja e Metropole Aix-Marseille-Provence dhe Këshillit të Departamentit Bouches-du-Rhône, Benoit Payan, Kryetar i Bashkisë së Marsejës dhe André Viola, Kryetar i Delegacionit Francez në Komitetin European të Rajoneve.

Programi u strukturua rreth katër temave:

- Territoriet europiane përballen me sfida të mëdha shoqërore: Ky debat plenar dhe tre tryeza të rrumbullakëta të nivelit të lartë u fokusuan në rritjen e qëndrueshmërisë shëndetësore, përsheptimin e tranzicionit dixhital dhe parashikimin, parandalimin dhe përshtatjen ndaj rreziqeve klimatike. Folësit kryesorë ishin Werner Hoyer, President i Bankës Europiane të Investimeve, Frans Timmermans, Zëvendës-President Ekzekutiv i Komisionit European,

David Gallagher, President Rajonal i Pfizer dhe Mami Mizutori, Kryetare e UNDRR.

- Kohezioni dhe rimëkëmbja: Roli i politikës së kohezionit të BE-së në rimëkëmbjen pas pandemisë ishte tema e një debati me Elisa Ferreira, Komisionere Europiane për Kohezionin dhe Reformat, Jacqueline Gourault, Ministre Franceze e kohezionit territorial dhe autoritetet lokale dhe rajonale dhe Younous Omarjee, Kryetar i Komitetit REGI të Parlamentit European. Ringjallja e zonave rurale, bashkëpunimi ndërkufitar, partneriteti

euro-mesdhetar dhe zgjerimi i BE-së, ishin ndër temat e diskutimeve të tryezës së rrumbullakët.

- Ndërtimi i Shtëpisë së Demokracisë Europiane: Zëvendës presidentët e Komisionit European, Margaritis Schinas (Promovimi i mënyrës sonë europiane të jetës) dhe Dubravka Šuica (demokracia dhe demografia), Presidentja e Parlamentit European Roberta Metsola, Christa Schweng, Presidente e Komitetit European Ekonomik dhe Social, Vasco Alves Cordeiro, Zëvendës president i Parë i Komitetit European të Rajoneve, dhe euro-deputetja Eva Maydell, Presidente e Lëvizjes Ndërkombëtare Europiane, iu bashkuan debatit me liderët lokalë mbi gjendjen e zhvillimit të Konferencës “E ardhmja e Europës”, e cila synon t'u japë qytetarëve europianë një zë më të fortë në procesin e vendimmarrjes së BE-së. Gjithashtu u diskutua roli i autoriteteve lokale dhe rajonale në promovimin e vlerave demokratike europiane.

- E ardhmja e Demokracisë Europiane: Angazhimi i të rinjve dhe vlerat europiane: Diskutimet kishin si temë zgjerimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën qytetare dhe demokratike, në kontekstin e transformimit dixhital dhe sfidave ndaj vlerave europiane. Sesioni i fundit përfshiu nisjen e procesit të bashkë-krijimit të një Karte Europiane për Rininë dhe Demokracinë, dhe një shkëmbim frymëzues midis Presidentes së Forumit Rinor European Silja Markkula dhe presidentëve bashkë-pritës të Samitit, Apostolos Tzitzikostas dhe Renaud Muselier.

Komisioni European zgjedh 50 kompani të udhëhequra nga gra, për të nxitur inovacionin e teknologjisë në Europë

Skema pilot e nisur më 13 korrik mbështet një grup të parë prej deri në 50 biznese të reja premtoese të udhëhequra nga gratë, duke filluar nga viti 2022.

Komisioni njoftoi rezultatet e thirrjes së parë në kuadër të programit të ri pilot “Women TechEU”, duke mbështetur start-up-et e teknologjisë së thellë të udhëhequra nga gratë. Thirrja financohet në kuadër të programit të punës për Ekosistemet Europiane të Inovacionit të Horizon Europe, programi i BE-së për kërkimin dhe inovacionin.

Mariya Gabriel, Komisionerja për Inovacionin, Kërkimin, Kulturën, Arsimin dhe Rininë tha: “Jam veçanërisht krenare për rezultatet e suksesshëm të thirrjes së parë “Women TechEU”. Numri i lartë i aplikacioneve të jashtëzakonshme konfirmon se ka nevojë që gratë në teknologjinë e thellë të marrin mbështetje për kompanitë e tyre në fazën e hershme, më të rrezikshme. Ne do t'i ndihmojmë këto 50 kompani të udhëhequra nga gratë me financim, mentorim dhe mundësi rrjetëzimi dhe do ta rrisim këtë program në vitin 2022.

Women TechEU është një nismë krejt e re e Bashkimit European. Skema ofron grante, me vlerë 75,000 secili, për të mbështetur hapat fillestarë në procesin e inovacionit dhe rritjen e kompanisë. Ai gjithashtu ofron mentorim dhe stërvitje në kuadër të Programit të Leadershipit të Grave të Këshillit European të Inovacionit (EIC) dhe mundësi rrjetëzimi në mbarë BE-në. Pas vlerësimit nga ekspertë të pavarur, Komisioni do të mbështesë një grup të parë prej 50 kompanish të udhëhequra nga gratë nga 15 vende të ndryshme. Mbi 40 kompani janë të bazuara në Shtetet Anëtare të BE-së, duke përfshirë një të pestën nga vendet në zgjerim të “Horizon Europe”. Gjithashtu, afërsisht një e pesta janë të bazuara në vendet e lidhura me “Horizon Europe”. Kompanitë e propozuara për financim kanë zhvilluar inovacione të fundit dhe përcarëse, në një sërë fushash, nga diagnoza dhe trajtimet e hershme të kancerit, deri te reduktimi i ndikimit negativ të emetimeve të metanit. Ato adresojnë qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm (SDG), si trajtimi i ndryshimeve klimatike, reduktimi i mbetjeve ushqimore, si dhe zgjerimi i aksesit në arsim dhe fuqizimi i grave.

Projektet do të fillojnë në pranverë të vitit 2022 dhe pritet të zgjasin 6 deri në 12 muaj. Gratë udhëheqëse do të regjistrohen në Programin e Leadershipit të Grave të Këshillit European të Inovacionit për aktivitete të përshtatura për trajnim dhe mentorim. Buxheti për thirrjen e ardhshme do të rritet në 10 milionë euro, që do të financojë afërsisht 130 kompani (nga 50 këtë vit). Thirrja do të nisë në vitin 2022.

Teknologjia e thellë përbën më shumë se një të katërtën e ekosistemit fillestar të Evropës, me kompanitë europiane të teknologjisë së thellë që tani vlerësohen në një total prej 700 miliardë eurosh. Megjithatë, gratë mbeten kryesisht pak të

përfaqësuar në teknologjinë e thellë.

Të themeluara në inovacionin në inxhinieri dhe përparimet në shkencë, start-up-et e teknologjisë së thellë priren të kenë cikle më të gjata dhe shpesh kërkojnë më shumë kohë dhe kapital për t'u ndërtuar se sipërmarrjet e tjera fillestare. Shumica mund të dështojnë në vitet e tyre të para nëse nuk marrin mbështetjen dhe investimin e duhur herët. Gratë në teknologjinë e thelluar shpesh përballen me pengesat shtesë të paragjytimeve dhe stereotipeve gjinore, veçanërisht të përhapura në sektorë si teknologjia.

Për çdo grua që nuk ka mundësi të hapë dhe drejtojë një kompani teknologjike, Europa humbet, jo vetëm në talentin dhe diversitetin, por gjithashtu mund të rezultojë në mundësi të humbura për rritje ekonomike. Programi i ri “Women TechEU” trajton këtë hendek gjinor të inovacionit duke mbështetur start-up-et e teknologjisë së thellë të udhëhequra nga gratë në fazën e hershme, më të rrezikshme të kompanive. Me këtë skemë BE-ja kërkon të ndihmojë në rritjen e numrit të bizneseve fillestare të udhëhequra nga gratë dhe të krijojë një ekosistem europian më të drejtë dhe më të begatë të teknologjisë së thellë. “Women TechEU” është pjesë e një sërë masash të BE-së për të nxitur femrat novatore. Iniciativat kryesore përfshijnë Çmimin e BE-së për Gratë Novatore, objektiva ambicioze të vendosjes për kompanitë e udhëhequra nga gratë nën Përsheptuesin e Këshillit European të Inovacionit, një Bord EIC i balancuar gjinor, integrimin e dimensionit gjinor në Sfidat përkatëse të EIC dhe një indeks pilot të inovacionit gjinor dhe diversitetit. Çmimi i BE-së për Gratë Inovatore mori një rekord prej 264 aplikimesh në vitin 2021, duke sinjalizuar numrin në rritje të shpejtë të bizneseve fillestare të udhëhequra nga gratë në Europë. Çmimi promovon gratë që qëndrojnë pas inovacioneve përparimtare të Europës dhe kërkon të krijojë modele për gratë dhe vajzat kudo. Financuar në kuadër të programit të punës së Ekosistemeve Europiane të Inovacionit të “Horizon Europe”, “Women TechEU” është një nismë krejt e re e Bashkimit European. Skema ofron trajnime dhe mentorim të klasit të parë për themelueset femra, si dhe financim të synuar për të ndihmuar në ngritjen e biznesit të tyre në një nivel tjetër. “Women TechEU” ofron:

-Mbështetje financiare për kompanitë, si grant individual prej 75 000 euro për të mbështetur hapat fillestarë në procesin e inovacionit dhe rritjen e kompanisë.

-Mentorim dhe trajnim të ofruar nga Shërbimet e Përsheptimit të Biznesit të EIC (BAS), në kuadër të “Programit të Leadershipit të Grave”, i cili përfshin ngjarje të dedikuara për rrjetëzim dhe prezantim.

-Mundësi për të marrë pjesë në aktivitete të dedikuara të organizuara nga “InvestEU” dhe “Enterprise Europe Network”.

2 mars 1444, Kuvendi i Lezhës dhe krijimi i Besëlidhjes Shqiptare

Ishte 2 marsi i vitit 1444, kur Gjergj Kastrioti, pas kthimit nga Turqia, për herë të parë mbledhi në një kuvend të gjitha principatat shqiptare, me qëllim përballimin e sulmit otoman. Pikërisht, realizimi i bashkimit të të gjithë princave shqiptarë në një kuvend të përbashkët nga ana e Skënderbeut përbën edhe një ndër idetë më të mëdha e novatore të tij.

Duke shfletuar kalendarin historik, më 2 mars, kujtojmë 578 vjetorin e Kuvendit të Lezhës, ku u hodhën themelet e bashkimit kombëtar, mbajtur në vitin 1444, në Kishën katedrale të Shën Kollit, në Lezhë, që njihet si Besëlidhja e Lezhës. Pikërisht, më 2 mars 1444 në Kishën katedrale të Shën Kollit në qytetin e Lezhës, ku sot gjendet edhe memoriali i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, u mbajt Besëlidhja e Lezhës, një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar gjatë periudhës së mesjetës e të tërë historisë kombëtare.

Ishte 2 marsi i vitit 1444, kur Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, menjëherë pas kthimit nga Turqia, për herë të parë në historinë e mesjetës shqiptare mbledhi në një kuvend të gjitha principatat shqiptare, me qëllim përballimin e sulmit otoman. Pikërisht, realizimi i bashkimit të të gjithë princave shqiptarë në një kuvend të përbashkët nga ana e Skënderbeut përbën edhe një ndër idetë më të mëdha e novatore të tij.

Në Kuvendin e Lezhës u mbledhën principatat shqiptare nga veriu në jug, ku më të rëndësishmet ishin Arianitasi, Dukagjinasit, Balshajt dhe Topiat, ndërsa nga pikëpamja ballkanike në të mori pjesë dhe princi i Malit të Zi.

Kuvendi vendosi komandant të përgjithshëm të Lidhjes, Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, duke njohur autoritetin e tij politik dhe ushtarak. Që prej këtij bashkimi udhëheqësi legjendar rriti rezistencën e ushtrisë së tij dhe drejtoi luftën, për 25 vite me radhë, kundër pushtimit otoman. Kuvendi realizoi Besëlidhjen e madhe shqiptare, që i dha jetë shtetit më të fuqishëm mesjetar të Arbrit, ku u farkëtua shpirti i arbërve dhe identiteti ynë kombëtar.

Po t'i referohesh dokumentacionit historik, kuvendi i Besëlidhjes nuk u mbajt rastësisht në qytetin e Lezhës, i cili në atë kohë ishte në zotërimin e Venedikut. Kjo ngjarje e rëndësishme u zhvillua në këtë qytet, pasi Lezha nuk përfaqësonte kryeqendrën e principatave dhe në këtë mënyrë shmangeshin grindjet e mundshme dhe krijoheshin ideja e barazisë.

Kjo është cilësuar nga shumë figura të asaj kohe edhe si një nga

“Lirinë nuk ua solla unë, atë e gjeta mes jush!
Lirinë e pashë se e keni kudo, në krahavor, në ballë, në shpatat e në ushtat” (Skënderbeu)



”

Ishte 2 marsi i vitit 1444, kur Gjergj Kastrioti -Skënderbeu, menjëherë pas kthimit nga Turqia, për herë të parë në historinë e mesjetës shqiptare mbledhi në një kuvend të gjitha principatat shqiptare, me qëllim përballimin e sulmit otoman. Pikërisht, realizimi i bashkimit të të gjithë princave shqiptarë në një kuvend të përbashkët nga ana e Skënderbeut përbën edhe një ndër idetë më të mëdha e novatore të tij.

veprimet diplomatike të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Kuvendi u mbajt në Lezhë, duke ditur faktin se Lezha me anë të pushtetit venedikas do të shërbente edhe si faktor përkrashje në Europë, pasi një nga idetë më të mëdha të Lidhjes ishte integrimi i Shqipërisë në Europën perëndimore.

Besëlidhja e Lezhës përbën një prej ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së mesjetës, prandaj 2 marsi i vitit 1444 nuk është thjeshtë një datë, është një mesazh, aq më tepër në një realitet që prirët gjithnjë e më shumë ta lexojë me indiferencë historinë, të harrojnë mësimet që vijnë prej saj, të jetojnë vetëm për të sotmen e të mohojë të djeshmen e largët e të afërme, e aq më keq, të nesërmen, duke harruar se nuk mund të ndërtohen njëra pa tjetrën.

2 marsi është mesazhi i bashkimit, në një, për Atdheun, që ka nevojë më shumë se kurrë t'i shikojë të gjithë bijtë e vet të ndershëm një mendjeje e një zemre, që jetojnë e punojnë për të mirën e përbashkët, për të mirën e të gjithëve.





LUFTA NË UKRAINË

